

ANNUAL REPORT 2016



abi AMERICAN BANK
OF INVESTMENTS

ANNUAL **REPORT** 2016

**ANNUAL
REPORT
2016**

6

Mesazh i Kryetares së Këshillit Drejtues
dhe Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv

8

Informacion mbi Grupin

10

Qeverisja e Korporatës

12

Aktiviteti kryesor Financiar gjatë vitit 2016

14

Burimet Njerëzore

16

Rrjeti i degëve

18

Struktura Organizative

20

Përgjegjësia Sociale 2016

26

Pasqyrat Financiare 2016

MESAZH I KRYETARES SË KËSHILLIT DREJTUES DHE DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Mesazhi kryesor i raportit vjetor 2016, është një mesazh krenarie dhe mirënjohje për klientët dhe punonjësit e Bankës Amerikane të Investimeve, që gjatë këtij viti mundësuan rikthimin e bankës në një aktivitet të shëndetshëm dhe fitimprures, me një fitim mbi Eur 3.2 milione. ABI Bank është një institucion me një të tashme të suksesshme dhe të ardhme shumë premtuese. Ne i mbajtmë të gjitha premtimet tona duke mundësuar gatishmëri absolute ndaj klientëve në shërbimet e kërkuara, pasion në punën tonë të përditshme dhe një paraqitje dinjitoze dhe të sofistikuar të bankës në treg. Një vit më parë Banka Amerikane e Investimeve ishte më shumë një premtim. Sot, ABI Bank është një realitet inkurajues për tregun bankar në Shqipëri.

Viti 2016 ishte një vit pozitiv për ekonominë shqiptare që shënoi një rritje 3.5% të prodhimit bruto. Për sistemin bankar ky rezultat është akoma më inkurajues kur krahasohet me problemet ekonomike të rajonit. Sistemi bankar në Shqipëri shënoi hapa pozitiv sidomos në uljen e peshës së kredive të këqija, stabilitetin e interesave dhe nivelin e mjaftueshmerisë së kapitalit.

Për Bankën Amerikane të Investimeve viti 2016 ishte viti i një rritjeje rekord në sistemin bankar dhe afirmimit në treg si një banke e shëndetshme dhe e suksesshme. ABI Bank, për herë të parë në tregun bankar shqiptar krijoi një precedent pozitiv të blerjes së një banke me humbje disa vjeçare dhe transformimit të saj në një bankë të shëndetshme dhe të suksesshme. Vlen të theksohet se Banka jonë ka një histori 17 vjeçare që prej hapjes së saj në vitin 1999 dhe janë vlerat pozitive të kësaj historie të gërshetuara me drejtimin dhe frymën e re që mundësuan këtë transformim të shpejtë dhe të suksesshëm.

Si arritje kryesore të punonjësve të ABI Bank për 2016 mund të listonim:

- Pastrimin e bilancit të bankës duke ulur nivelin e kredive të keqija në 17.6% (nën mesataren e tregut) nga 35.2% në Shtator 2015.
- Raportimin e fitimit në nivelin Eur 3.2 milionë dhe fitimshmëri ndër më të lartat në treg.
- Rritjen e bilancit të bankës me shifra rekord gjatë 12 muajve - rritja e aktiveve dhe depozitave ishte mbi 40%, me një total Eur 273 milionë.
- Përmirësimin në mënyrë domethënëse të mjaftueshmërisë së kapitalit në 22% nga 12% që është kërkesa e tregut dhe 15.8% në fund të 2015.
- Krijimin e një emri dhe brandimi të njohur dhe të mirëpritur në treg.
- Krijimin e një kulture të fortë integriteti, përkushtimi ndaj klientit, pozitiviteti dhe profesionalizmi.
- Ndryshimin e pamjes së shumë prej degëve.
- Përmirësimin e kulturës së brendshme, krijimin e të parës bankë "butik" në Shqipëri dhe prezantimin e shërbimit VIP me një departament të dedikuar për këtë grup klientësh.
- Forcimin e kulturës së kredidhënies, analizës së rrezikut, kontrolleve të brendshme, dhe krijimin e operacioneve retail të fokusuar të klienti.
- Rritjen në vlerësimin e entitit regullator si dhe në renditjen në tregun bankar shqiptar.

Motoja e Bankës Amerikane të Investimeve është "Investo në Optimizëm". Kjo moto përfaqëson dhe shpjegon më së miri sukseset e vitit 2016 dhe aspiratat e ABI Bank për vitet në vazhdim. Kultura e optimizmit është në thelb të mënyrës së të bërit biznes në një bankë Amerikane. ABI Bank jeton dhe punon përditë me optimizëm dhe besim për të sjellë shërbimet dhe produktet më cilësore në tregun shqiptar. Pasioni, sofistikimi, dhe përshtatja

ndaj kërkesave të klientit është në thelb të konceptit “Butik” të Bankës Amerikane të Investimeve dhe ndryshimi thelbësor nga bankat e tjera në treg. Ky koncept është një premtim dhe përkushtim total ndaj klientit, në cilësi, sasi dhe kohë për produkte dhe shërbime të personalizuar dhe të sjella me një grup vlerash të larta integriteti dhe pozitiviteti.

Gjatë vitit 2016 shumë kohë dhe para janë shpenzuar në përmirësimin e aftësive analizuese dhe kulturës në bankë duke sjellë ekspertizë dhe ekspertë Amerikane. Ky proces i filluar në 2016 do të vazhdojë gjatë viteve të ardhshme për të krijuar bankën më të suksesshme në treg për nga komunikimi dhe shërbimi cilësor ndaj klientit.

E thënë thjesht, përkushtimi ynë ndaj klientëve është në qendër të veprimeve tona dhe drejton punën dhe rezultatet tona. Qëllimi ynë, nuk është vetëm të tërheqim klientë- është të tërheqim klientë të cilët e shohin ABI Bank si bankën e tyre kryesore. Ne duam të jemi zgjedhja e parë e klientit kur kërkojnë këshilla financiare.

2016 ishte gjithashtu viti ku Banka investoi ndjeshëm në komunitetin e shumë qyteteve ku ne kemi prezencë. Ky kontribut u vlerësua me dy nga çmimet më të rëndësishme në vend për politikën sociale të korporatës si Bleta e Artë për vitin 2016 i cili është çmimi më prestigjioz në vend për politikën sociale të kompanive të ndryshme dhe Çmimi Banka Për Komunitetin për qytetin e Tiranës. Mundësia për të ndihmuar komunitetin është privilegj dhe ne do të vazhdojmë të japim

kontributin tonë në këtë drejtim.

ABI Bank vazhdon të përfitojë nga një avantazh i qartë dhe afatgjatë i marrëdhënies të ngushtë me Tranzit Financë, që është kompania më e madhe dhe e specializuar në Shqipëri për trajtimin e kredive të këqija. Objektivi afatmesëm është që ABI të ketë portofolin me kreditë më të shëndetshme në treg. Në sajë të përkushtimit të vazhdueshëm ndaj cilësisë së portofolit pritet që në 2017 niveli i kredive të këqija për Bankën Amerikane të Investimeve të ulët në 9%.

Gjatë 2017, rritja e bankës do të përqendrohet në konsolidimin e aktiviteteve të retail dhe kredidhënies. Tregu bankar ofron mundësi interesante për rritje organike kryesisht nga klientë që pas një periudhë të gjatë bankimi në masë kërkojnë vëmendje dhe kujdes të personalizuar. ABI Bank i ka të gjitha mundësitë të vazhdojë rritjen dy shifrore gjatë 2017 dhe të rrisë pozicionin e saj në klasifikimin e sistemit bankar.

Rrugëtimi i ABI Bank është një ndërmarrje afatgjatë ku integriteti, përkushtimi, pozitiviteti, dhe perfeksionimi profesional do të testohen çdo ditë. Ne jemi të vendosur të perfeksionojmë shërbimin “butik” që në thelb ka pasionin dhe përkushtimin total në mundësimin e shërbimeve më të sofistikuar të klientëve më të sofistikuar. ABI Bank është shumë e rëndësishme për ne dhe ndihemi me fat për besimin që na jepet nga klientët, punonjësit, bordi, dhe aksionerët tanë të nderuar.

Kathryn Swintek

Kryetare e Këshillit Drejtues

Andi Ballta

Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv

INFORMACION MBI GRUPIN

Banka Amerikane e Investimeve është pjesë e grupit Amerikan NCH Capital, me investime globale dhe qendër në New York.

NCH Capital Inc.

- NCH Capital është një nga investitorët më të mëdhenj dhe të mirënjohur amerikanë me mbi 3 miliardë dollar nën administrim.
- Duke filluar nga viti 1992, NCH Capital ka krijuar një eksperiencë të gjatë në Europën Lindore me projekte dhe investime të rëndësishme në Rumani, Bullgari, Angli, Greqi, Ukrainë, Letoni, Moldavi, Serbi, Mal i Zi, Kroaci, Rusi, Brazil dhe Shqipëri.
- NCH Capital është i regjistruar me autoritetet më prestigjioze mbikqyrëse Amerikane (Securities and Exchange Commission).
- Në fushën financiare NCH Capital ka patur përvojë të gjatë dhe të suksesshme në administrim bankash, shoqëri sigurimesh dhe institucione financiare në Rumani, Moldavi, Letoni dhe Shqipëri.
- Në vitin 2007, NCH Capital filloi investimet në Shqipëri duke krijuar zyrën rajonale për Ballkanin Përfundimor dhe Greqinë.

Për më shumë informacion rreth NCH Capital vizitoni www.nchcapital.com

Tranzit Finance

- Tranzit Finance është kompani e grupit NCH Capital dhe është licensuar në vitin 2010 nga Banka e Shqipërisë si Institucion Financiar.
- Tranzit Finance është kompania më e madhe dhe e specializuar në Shqipëri për trajtimin e kredive të këqija. Rezultatet e Tranzit vijnë nga dedikimi për t'ju ofruar klientëve shërbime cilësore dhe efektive me integritet të lartë.
- Në fund të vitit 2016 Tranzit numëronte 69 punonjës duke i shërbyer 88'931 klientëve në të gjithë Shqipërinë me kredi për individë dhe biznese.
- Tranzit Finance jep një kontribut të veçantë në uljen e portofolit të kredive me problem në sistemin bankar Shqiptar.

Për më shumë informacion rreth Tranzit Finance vizitoni www.tranzit.com.al

QEVERISJA E KORPORATËS

Banka Amerikane e Investimeve SHA operon në bazë të Statutit, legjislacionit shqiptar në fuqi, standardeve profesionale, Kodit të Sjelljes dhe kornizës rregullatore, siç kërkohet çdo herë nga autoritetet rregullatore kompetente.

Kjo rregullore përfshin rregullat e brendshme të Bankës, parimet dhe mekanizmat e kontrollit në bazë të të cilave banka organizohet dhe menaxhohet, duke adoptuar një strukturë e cila është transparente për investitorët, duke njohur dhe respektuar të drejtat e personave të cilët ndikohen nga aktiviteti bankar dhe duke siguruar interesat legjitime të aksionerit të vetëm të Bankës. Principet bazë të Kodit të Bankës mbi Qeverisjen e Korporatave përshkruhen në vijim:

1.1. Të drejtat e aksionerit dhe trajtimi i barabartë

Banka ka vendosur rregullat që garantojnë udhëzimet e plota të aksionerëve mbi kushtet financiare të Bankës, si edhe mbi vendimet e Menaxhimit që ndikojnë ndjeshëm në kursin e saj të mëtejshëm. Nga çdo Aksion i Bankës rrjedhin të drejta dhe detyrime të barabarta.

1.2. Përbërja e Bordit të Drejtorëve

Bordi i Drejtorëve të Bankës mund të përbëhet nga anëtarë ekzekutivë, joekzekutivë dhe joekzekutivë të pavarur.

1.3. Detyrat e Bordit të Drejtorëve

Bordi i Drejtorëve specifikon vizionin, misionin dhe strategjinë e Bankës, ndjek rritjen afatgjatë të vlerës

ekonomike të saj, duke monitoruar, drejtuar dhe audituar ekzekutivin, në emër të Aksionerëve.

1.4. Konflikti i interesit

Banka ka miratuar një politikë standarde të menaxhimit të konfliktit të interesit duke u fokusuar në identifikimin, parandalimin, menaxhimin dhe korrigjimin e rasteve që përbëjnë ose shkaktojnë konflikt interesi duke garantuar transparencë në lidhje me informacionin për rastet e konflikteve të interesit aktual dhe potencial (Politika e Menaxhimit të Konfliktit të Interesave). Politika e Menaxhimit të Konfliktit të Interesit të Bankës Amerikane të Investimeve SHA përfshin të gjitha veprimtaritë që ushtrohen nga Banka lidhur me palë të treta, ku përfshihen drejtpërdrejt ose jo anëtarë të Këshillit Drejtues të Bankës.

1.5. Shpërblimi i Anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të Bankës

Pagesa e anëtarëve të Këshillit Drejtues të cilët nuk janë pjesë e stafit të punonjësve është e përcaktuar sipas marrëveshjes me Aksionerin e Bankës, dhe ata nuk janë pjesë e skemës së shpërblimeve të stafit për performancën.

Politika e shpërblimeve të stafit për performancën do të miratohet gjatë vitit 2017.

1.6. Auditimi i Brendshëm

Banka disponon një Sistem të organizuar të Auditit të Brendshëm (Departamenti i Auditit të Brendshëm), i cili kontrollohet nga Komiteti i Auditit të Bankës.

KËSHILLI DREJTUES:

Kathryn Swintek	Kryetare e Këshillit Drejtues (joekzekutive e pavarur)
ERNST Rezzo Schlauch	Zëvendës Kryetar i Këshillit Drejtues (joekzekutiv i pavarur)
Mark Crawford	Anëtar i Këshillit Drejtues (joekzekutiv i pavarur)
Andi Ballta	Anëtar i Këshillit Drejtues (Drejtor Ekzekutiv i Përgjithshëm)
Armand Muharremi	Anëtar i Këshillit Drejtues (Drejtor i Divizionit të Financës)
Lindita Rama	Anëtare e Këshillit Drejtues (joekzekutive e pavarur)
Richard Lukaj	Anëtar i Këshillit Drejtues (joekzekutiv i pavarur)

Komiteti	Qëllimi i Komitetit
Komiteti i Çështjeve Delikate dhe Provigjionimit	Ky komitet vlerëson në baza frekvente Koston e Riskut të Kredisë si dhe të Risqeve të tjera operationale që gjeneron Banka. Gjithashtu në këtë Komitet monitorohet performanca e mbledhjes së kredive të këqija dhe sensitive, si dhe përcaktohen strategjitë e përgjithshme apo specifike që duhet të ndiqen në lidhje me klientët në vonesë/të fshirë nga librat e Bankës.
Komiteti i Kredisë	Komiteti i Kredisë është organi më i lartë vendimarrës për pranimin (ose refuzimin) e riskut të kredisë në librat e Bankës. Komiteti i Kredisë operon brenda disa kriterëve dhe limiteve të mirëpërcaktuara nga Këshilli Drejtues duke respektuar politikën dhe strategjinë e Bankës në lidhje me riskun e kredisë. Ai kryesohet nga CEO dhe përbëhet nga 6 anëtarë të përhershëm.
ALCO	ALCO aprovon produktet e reja që do të hidhen në treg nga Banka, lidhur me pëqindjet e interesave të depozitave, të produkteve të kredidhënies, strategjinë e Bankës për investimet, konvertimet nga monedha ALL në monedhën e Kapitalit.
Komiteti i Kontrollit të Brendshëm	Komiteti i Auditit të Brendshëm përbëhet nga tre anëtarë që emërohen nga asambleja e aksionerëve për një periudhë 4 vjecare, me të drejtë rizgjedhjeje. Ky komitet monitoron efektivitetin e njësisë së kontrollit të brendshëm dhe siguron që kjo njësi t'i kryejë përgjegjësitë e saj në mënyrë të pavarur dhe në bazë të standardeve të kontrollit të brendshëm. Gjithashtu Komiteti siguron që Njësia e Auditit të Brendshëm të ketë komunikim të hapur dhe të vazhdueshëm me drejtorinë, ekspertët kontabël të autorizuar dhe autoritetin mbikëqyrës, si dhe që Banka të ketë ngritur dhe të mbajë një linjë të parë dhe të dytë të kontrollit të brendshëm, të mjaftueshëm dhe efektive, duke siguruar në vazhdimësi mbarëvajtjen e proceseve në fusha të tilla si: raportimi (financiar, operacional, i rrezikut), monitorimi i përputhshmërisë me ligjet, me aktet nënligjore dhe me aktet e brendshme, si dhe efica dha dhe efektiviteti i operacioneve dhe ruajtjes së aktiveve.

AKTIVITETI KRYESOR FINANCIAR GJATE VITIT 2016

Ecuria dhe treguesit kryesorë gjatë 2016-ës

Banka Amerikane e Investimeve realizoi me sukses gjatë vitit 2016 një proces jo të lehtë rritjeje, konsolidimi dhe përmirësimi strukturor të aktivpasivëve të saj. Aktiviteti i Bankës u zgjerua ndjeshëm duke reflektuar rritjen më të madhe në industrinë bankare, mbi 40%, të volumeve të aktiveve dhe depozitave të klientëve, krahasuar me volumet e një viti më parë.

Aktiviteti i kredidhënies raportoi një rritje prej 5% për vitin 2016. Ky tregues është plotësisht brenda parashikimeve dhe pritshmërisë së Administrimit të Lartë të ABI-it pasi përfaqëson rezultantin e një procesi të vazhdueshëm të përmirësimit të cilësisë së portofolit të kredisë të Bankës të kombinuar me rritjen e kujdesshme të kredisë së re, të sinkronizuar

me rritjen e bazës së klientelës, produkteve dhe kapaciteteve të kredidhënies. Kredia me probleme rezultoi 17.6% në Dhjetor 2016, krahasuar me 21% në Dhjetor 2015. Kjo ecuri paralajmëron arritjen e një prej objektivave kryesorë të Bankës, atë të raportimit të një cilësie rekord të portofolit të kredisë, me një tregues të kredisë me probleme nën nivelin 10% në Dhjetor 2017.

Banka vijoi të optimizojë kanalizimin e likuiditeteve të saj në investime me rrezik të ulët dhe likuiditet të lartë të Letrave me Vlerë të Qeverisë Shqiptare. ABI luajti një rol parësor dhe mjaft të rëndësishëm në tregun primar të emetimit të këtyre instrumenteve duke rritur me mbi 200% portofolin e investimeve krahasuar me fundin e vitit 2015. Struktura dhe kthimi i portofolit paraqiten mjaft të kënaqshme. Në 31 Dhjetor 2016 këto investime



përbëjnë rreth 45% të totalit të aktiveve duke e renditur ABI-n si bankën me kontributin më të lartë, në raport me totalin e aktiveve, në financimin e huamarrjes dhe projekteve publike të Qeverisë Shqiptare.

Viti 2016 konsolidoi përfitueshmërinë e Bankës. Optimizimi strukturor i aktiv-pasiveve dhe investimeve të likuiditeteve siguruan dy-fishimin e të ardhurës neto bankare krahasuar me vitin paraardhës. Nga ana tjetër, u rishikuan të gjithë elementet e kostove të aktivitetit duke arritur ulje me mbi 20% të shpenzimeve të përgjithshme operative. Për herë të parë Banka raportoi për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016 tregues pozitivë të përfitueshmërisë dhe performancës në të gjitha

dimensionet apo nivelet e aktivitetit. Treguesi i kostove ndaj të ardhurave të aktivitetit rezultoi pozitiv, nën nivelin 100%. Kthimi ndaj Kapitalit Neto Aksionar (RoE) dhe Totalit të Aktiveve (RoA) rezultuan në nivele rekord për Bankën dhe më të lartat krahasuar me industrinë bankare. Për më tepër, treguesit e Mjaftueshmërisë së Kapitalit dhe Likuiditetit shënuan përkatësisht vlerat 22% (mesatarja e industrisë rreth 15.7%) dhe 50% (mesatarja e industrisë rreth 40%) duke rezultuar gjithashtu më të lartat në sistemin bankar.


Në këto kushte Banka siguroi stabilitet të plotë si dhe një bazë të konsoliduar për rritjen dhe përmirësimin e mëtejshëm të aktivitetit e treguesve të saj për vitin 2017.

PUNONJËSIT TANË


Ne në Bankën Amerikane të Investimeve besojmë në faktin që punonjësit tanë janë një avantazh i rëndësishëm konkurrues. Ne besojmë që pjesëmarrja aktive e punonjësve tanë është çelësi i arritjeve të synimeve të Bankës. Burimet njerëzore janë katalizatori i ndryshimeve, me besimin, dedikimin, aftësitë dhe dijet, si dhe me angazhimin që ata kanë. Ne kemi ristrukturuar proceset tona në lidhje me selektimin, trajnimin, zhvillimin, kompensimin dhe vlerësimin e performancës së punonjësve tanë.

38

MOSHA MESATARE
E PUNONJËSVE

MESHKUJ 

33%

FEMRA 

67%

VLERAT TONA TË PANEGOCIUESHME JANË:

Respekti për dinjitetin dhe të drejtat e punonjësve tanë, respekti për ndryshimet, ruajtja e sigurisë në punë, ndërthurja midis jetës profesionale dhe personale, zhvillimi dhe trajnimi i punonjësve dhe të gjitha këto brenda kuadrit të një Grupi të rëndësishëm siç jemi Ne.

Bazuar në traditën dhe trashëgiminë e Bankës sonë, ne punojmë sistematikisht për zhvillimin dinamik dhe të vazhdueshëm të Bankës. Vetëm në sajë të avantazhit që ne kemi për vlerat e Bankës dhe cilësinë e punonjësve tanë, ne arrijmë të formojmë një skuadër të fuqishme dhe të suksesshme.

PUNONJËS NË
ZYRAT QËNDRORE

144

NUMRI TOTAL
I PUNONJËSVE


243

(DHJETOR 2016)

NJËSITË
MBËSHTETËSE
49%

NJËSITË
MBËSHTETËSE
51%


RRJETI I DEGËVE



Në fund të vitit 2016-të, rrjeti i Bankës Amerikane të Investimeve numëronte 17 degë, 2 agjenci, dhe 32 ATM duke mbuluar qytetet më të mëdha në vend.



KËSHILLI DREJTUES



STRUKTURURA ORGANIZATIVE

KOMITETI I KONTROLLIT
TË BRENDSHËM

DIVIZIONI I
BURIMEVE NJERËZORE

DIVIZIONI I MENAXHIMIT
TË RISKUT & KONTROLLIT
TË VAZHDUESHËM

SEKTORI I
PËRPUTHSHMËRISË

SEKTORI I SHËRBIMEVE
TË PËRGJITHSHME
ADMINISTRATIVE

DIVIZIONI I FINANCËS

DIVIZIONI I
OPERACIONEVE
BANKARE

DIVIZIONI IT

DIVIZIONI I
REKUPERIMIT
TË KREDIVE

SIGURIA E
INFORMACIONIT

SEKTORI I
ADMINISTRIMIT
TË KREDIVE

NË NDIHMË TË KOMUNITETIT DHE PROMOVIMI I QYTETEVE TONA



“VRAPO PËR FËMIJËT”

Stafi i Bankës Amerikane të Investimeve mori pjesë në edicionin e 6-të të maratonës “Vrapo për fëmijët 2016”. Kjo maratonë kishte për qëllim mbledhjen e fondeve nga pjesëmarrës si qytetarë, grupe, institucione dhe biznese në Tiranë. Nisma ishte një mundësi për ta, ku nëpërmjet pjesëmarrjes në garë kontribuohet në mënyrë individuale ose në grup, për trajtimin mjekësor të fëmijëve që kurohen nga sëmundja e kancerit.



NË NDIHMË TË KOMUNITETIT LGBT

Banka Amerikane e Investimeve mbështeti organizimin e darkës gala “Përqafo ndryshimin, mbështet progresin”. Misioni i këtij aktiviteti ishte sigurimi i fondeve për vazhdimësinë e akomodimit, ushqimit, mbështetjes psiko-sociale, aftësimin për jetën, edukimin dhe punësimin për të rinjtë LGBT, të cilët janë viktimë të abuzimit dhe diskriminimit dhe jetojnë pranë Qendrës “Streha”.

MBËSHTETJE PËR SPITALIN RAJONAL TË DURRËSIT

ABI Bank sponsorizoi rehabilitimin e ambientit përreth Spitalit Rajonal Durrës, me qëllim krijimin e kushteve më të mira dhe pajisjen me një sistem parkimi të destinuar për stafin dhe të përshtatshëm për të sëmurët e spitalit sipas kushteve më bashkëkohore.



PROMOVIM I QYTETEVE DHE VLERAVE TE TYRE

Gjatë vitit 2016 ABI Bank ka qenë prezent në shumë qytete të vendit duke mbështetur projekte që synojnë pasurimin e jetës sociale të qytetarëve, promovimin e turizmit në vend dhe përmirësimin e kushteve të zhvillimit të biznesit. Gjatë sezonit veror në bashkëpunim me bashkitë e qyteteve ABI Bank mbështeti organizimin e një sërë aktivitetesh promovuese të turizmit të qyteteve: Sarandë "Çelja e sezonit turistik 2016", Kavajë aktiviteti "Bulevardfest" i organizuar nga artistët e rinj të qytetit, Korçë "Festa e Birrës 2016" dhe Gjirokastrë "Verë dhe Portokall".

Në muajin Nëntor ABI Bank ishte sponsor i aktivitetit "Mr.&Mrs. Investo në Pazar", i cili u organizua në pazarin e Korçës me qëllim promovimin e trashëgimisë kulturore të qytetit, si dhe nxitjen e bizneseve për të investuar në këtë hapësirë unike përse i përket arkitekturës dhe potencialit të zhvillimit. Gjithashtu në qytetin e Shkodrës, Banka ishte partnere në organizimin e festivalit tradicional "Lule Borë", i cili u rikthye pas 30 vjetësh mungese për publikun e qytetit, duke shpalosur vlerat e vjera të këngës qytetare shkodrane.

ARTI DHE KULTURA



PROMOVIM I QYTETEVE DHE VLERAVE TE TYRE

ABI Bank ishte sponsor zyrtar për vitin 2016 për aktivitetin e Qendrës Kulturore Tirana dhe Teatrit të Metropolit. Sezoni i pasur artistik i Teatrit të Metropolit ofroi për shikuesit vepra teatrore me nivel të lartë artistik duke promovuar gjithëpërfshirjen, dialogun konstruktiv dhe vlerat njerëzore universale. Banka Amerikane e Investimeve ka patur një bashkëpunim të ngushtë me artistët e skenës gjatë gjithë vitit 2016, duke qenë një partner i rëndësishëm në realizimin e projekteve të tyre të suksesshme si: komedia stand-up nga Gent Hazizi "Plako t'majt e jotja", monokomedia "Mbroni Shpellarin" me Romir Zallën, drama me subjekt shqiptar "Made in Albania" nga regjisori Altin Basha, "Nata Arabe" e vënë në skenë në Teatrin e Metropolit nga Stefan Capaliku. Një aktivitet i rëndësishëm ku ABI Bank ishte prezent ishte dhe festivali i dramës ballkanike "My name is Balkan", ku morën pjesë njëmbëdhjetë vepra nga dramaturgjia bashkëkohore e autorëve nga Ballkani.

"Film Music Pianodrom" ishte një tjetër projekt i realizuar në bashkëpunim me Bankën, ku muzika më e mirë e filmit shqiptar erdhi në piano nga pianistja Merita Rexha, e shoqëruar me recitime nga aktorja e mirënjohur Ema Ndoja. Në fund të vitit Banka Amerikane e Investimeve bashkëpunoi me Qendrën Kombëtare të Kulturës për Fëmijë duke mbështetur shfaqjen "Arrethyesi", në realizimin e të cilës u angazhuan rreth 100 fëmijë të kryeqytetit, të cilët shpalosën talentin e tyre në interpretim dhe balet.

Gjithashtu ABI Bank mbështeti dy projekte të rëndësishme të sezonit veror në kryeqytet si Kinemaja Verore në sheshin "Skënderbej", i cili iu mundësoi të gjithë dashamirësve të filmit të ndiqnin pa pagesë filma të përzgjedhur nga kinematografia botërore dhe koncertin e këngëtares së famshme me origjinë shqiptare Dua Lipa, i cili u ofrua falas për mijëra shikues në sheshin "Nënë Tereza".

PROMOVIMI I VENDIT TONË DHE MUNDËSIVE TË INVESTIMIT NË TË



ABI BANK MBËSHKETET "ALBANIA CALLS"

Abi Bank mbështeti projektin e AIDA (Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve) për realizimin e dy broshurave "Albania Calls", të cilat shpalosin për investitorët e huaj informacion të detajuar për kushtet dhe avantazhet e zhvillimit të biznesit në Shqipëri dhe japin një panoramë të gjithë potencialit ekonomik, natyror dhe industrial të vendit.

EDUKIM DHE SPORT



BANKIER PËR NJË DITË

Gjatë Javës Globale të parasë të gjitha degët e Bankës Amerikane të Investimeve në vend organizuan aktivitete duke mirëpritur fëmijë dhe të rinj në ambientet e degëve të bankës. Këto vizita iu shërbyen fëmijëve për tu njohur nga afër me rolin e bankave në shoqëri, si dhe me mënyrat më të mira për të krijuar një marrëdhënie të shëndoshë me paranë.



FESTA E TË DREJTAVE

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në bashkëpunim me ABI Bank, organizuan në 1 Qershor "Festën e të drejtave". Kjo festë mbylli me sukses Planin Kombëtar të Mobilizimit #UnëMbrojFëmijët, i cili vendos fëmijët në qendër të vëmendjes së shtetit, institucioneve, prindërve dhe shoqërisë.



BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE MBËSHTET SPORT KLUB STUDENTIN

Në kuadër të përgjegjësisë sociale që ABI Bank ndjek në gjithë aktivitetin e saj, mbështetja për një jetë të shëndetshme që ushtrimi i sportit siguron, është gjithmonë në fokus. Banka Amerikane e Investimeve është sponsori kryesor i të gjitha ekipeve sportive përbërëse të Klubit Sportiv "Studenti".



ÇMIME

Banka Amerikane e Investimeve u vlerësua në fund të vitit 2016 me dy çmime për Përgjegjësinë Sociale të Korporatës.

ABI Bank u nderua me çmimin “Bleta e Artë 2016” për Përgjegjësinë Sociale, për kontributin e saj në përmirësimin e jetës së komunitetit. Gjatë vitit 2016-të banka ka mbështetur një sërë projektesh me karakter social dhe kulturor, në fushat e turizmit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, me shtrirje jo vetëm në kryeqytet por dhe në qytetet më të rëndësishme në vend.

Ceremonia e ndarjes së çmimeve për bizneset më të mira të vitit u zhvillua në Pallatin e Kongreseve mbrëmjen e 28 Dhjetorit, nën kujdesin e veçantë të Kryeministrit z. Edi Rama. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte promovimi i sipërmarrjes shqiptare, punës dhe kontributit të saj në zhvillimin ekonomik të vendit dhe punësimin.

Çmimi për Përgjegjësinë Sociale të Korporatës iu dorëzua Drejtorit të Përgjithshëm të ABI Bank z. Andi Ballta nga Ministri i Financave z. Arben Ahmetaj.

“Bleta e Artë 2016” pasoi aktivitetin e ndarjes së çmimeve nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, i organizuar në dt. 17 Dhjetor, ku ABI Bank mori çmimin “Banka më pranë komunitetit”, në ceremoninë e organizuar në ambientet e Hotel Tirana International, në praninë e Kryebashkiakut z. Erion Veliqaj dhe bizneseve më të mira në kryeqytet.

Këto dy çmime nga bëjnë të ndihemi krenarë për punën dhe mbështetjen e rëndësishme që banka ka bërë në fushën e përgjegjësisë sociale, pasi theksojnë dhe njëherë objektivin që Banka Amerikane e Investimeve ka për të qenë sa më pranë popullit shqiptar dhe klientëve të saj. Mundësia për të ndihmuar është një privilegj i madh, ndaj dhe për vitin 2017 kjo fushë do të vazhdojë të jetë e rëndësishme dhe në fokusin e saj.



BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE

Pasqyrat Financiare për vitin
e mbyllur më 31 Dhjetor 2016

(së bashku me opinionin e audituesit të pavarur)

Raporti i audituesve të pavarur	28
Pasqyra e pozicionit financiar	30
Pasqyra e fitim humbjeve dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	31
Pasqyra e ndryshimeve në kapital	32
Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare	33
1. Subjekti raportues	34
2. Bazat e përgatitjes	34
3. Politikat kryesore kontabël	34
4. Standardet e reja dhe interpretime ende të pa miratuara	40
5. Menaxhimi i rrezikut	42
6. Përmbledhje e vlerësimeve dhe gjykimeve kontabël	58
7. Mjetet monetare dhe te ngjashme	60
8. Hua dhe paradhënie bankave	60
9. Investime financiare në letra me vlerë	61
10. Hua dhe paradhënie dhënë klientëve	62
11. Ndërtesa dhe pajisje	63
12. Aktivët afatgjatë jo-materiale	64
13. Inventari dhe mjete të tjera	64
14. Detyrime ndaj bankave	65
15. Detyrime ndaj klientëve	65
16. Borxhi i varur	66
17. Aktive tatimore të shtyra	67
18. Provizione të tjera	67
19. Detyrime të tjera	67
20. Kapitali aksionar	68
21. Rezerva ligjore	68
22. Rezerva të vlerës së drejtë	68
23. Të ardhura neto nga interesat	69
24. Të ardhura neto nga komisionet	69
25. Të ardhura të tjera, neto	70
26. Të ardhura të tjera operative, neto	70
27. Shpenzimet e personelit	70
28. Shpenzime të tjera administrative	70
29. Tatim fitimi	71
30. Angazhime dhe detyrimet e kushtëzuara	72
31. Çështjet ligjore	72
32. Angazhimet për qiratë dhe shpenzimet për qiratë operative	72
33. Transaksionet e palëve të lidhura	73
34. Ngjarjet pas datës së raportimit	73

RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR

Për aksionarin dhe drejtimin e Banka Amerikane e Investimeve Sh.a

KPMG Albania Shpk

Dëshmorët e Kombit Blvd
Twin Towers Building 1,
floor 13
Tirana, Albania
+355 (4) 2274 524
al-office@kpmg.com
kpmg.com/al

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Banka Amerikane e Investimeve Sh.a ("Banka"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me 31 dhjetor 2016, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në atë datë, si dhe shënime për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese. Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar të Bankës me 31 dhjetor 2016, të performancës së saj financiare dhe flukseve të saj të parasë për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesve për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Banka në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK) dhe me Kodin e Etikës të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar në Shqipëri (Kodi i IEKA), si dhe me kërkesat etike të Ligjit Nr. 10091, datë 5 mars 2009, "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar", të ndryshuar, që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin e BSNEPK dhe Kodin e IEKA.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Informacione të tjera

Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përfshijnë informacionet që jepen

në raportin vjetor, i përgatitur nga drejtimi në përputhje me Nenin 53 të Ligjit Nr. 9662, datë 18 dhjetor 2006 "Mbi bankat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, por këto informacione nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tonë të audituesve mbi këto pasqyra. Raporti vjetor parashikohet të na vihet në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesve. Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera, të identifikuar më lart kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare, apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me anomali materiale. Pasi të lexojmë raportin vjetor, nëse arrijmë në përfundimin se në këtë raport ka një anomali materiale, atëherë ne duhet të komunikojmë për këtë çështje me personat e ngarkuar me qeverisjen.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveçse në rastin kur drejtimi synon ta likuidojë Bankën ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

KPMG Albania Shpk, an Albanian limited liability company and a member firm of the KPMG network of independent member firms affiliated with KPMG International Cooperative ("KPMG International"), a Swiss entity.
Document classification: KPMG Confidential

Registered in the National Registration Center
with VAT Number J91619001D



Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë

procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, par jo për qëllime të shprehjes së një opinionit mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Bankës.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Bankës për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Banka të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Fatos Beqja

Auditues Ligjor
KPMG Albania Shpk
Blvd "Dëshmorët e Kombit"
Kullat Binjake, Kulla 1, Kati 13
Tiranë, Shqipëri

Tiranë, 30 mars 2017

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR (në mijë LEK)

Aktivitet	Shënime	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Mjetet monetare dhe të ngjashme	7	4,017,943	4,910,984
Hua dhe paradhënie bankave	8	3,126,071	4,367,509
Letra me vlerë të vendosjes	9	10,970,639	5,634,132
Letra me vlerë të investimit	9	6,888,858	-
Hua dhe paradhënie dhënë klientëve	10	9,289,448	8,799,326
Aktivitet afatgjata materiale	11	430,041	458,084
Aktivitet afatgjata jo-materiale	12	166,937	182,509
Të drejta tatimore të shtyra	17	3,168	3,884
Inventari dhe mjete të tjera	13	2,018,997	2,067,419
Totali i aktiveve		36,912,102	26,423,847
Detyrimet			
Detyrime ndaj bankave	14	926,609	172,940
Detyrime ndaj klientëve	15	31,459,195	22,848,075
Borxhi i varur	16	1,091,909	1,113,597
Provizione	18	55,747	50,098
Detyrime të tjera	19	372,601	158,604
Detyrime tatimore të shtyra	17	81,314	-
Totali i detyrimeve		33,987,375	24,343,314
Kapitali			
Kapitali aksionar	20	7,708,537	7,708,537
Rezerva ligjore	21	57,162	57,162
Rezerva të tjera	22	470,075	45,282
Humbja e akumuluar		(5,311,047)	(5,730,448)
Totali kapitalit		2,924,727	2,080,533
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		36,912,102	26,423,847

Shënimet shpjeguese të paraqitura në faqet 32 deri në 71 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E FITIM HUMBJEVE DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE (në mijë LEK)

	Shënime	2016	2015
Të ardhura nga interesat		1,314,238	1,013,675
Shpenzime për interesat		(443,617)	(369,861)
Të ardhura nga interesat, neto	23	870,621	643,814
Të ardhura nga tarifa dhe komisione		138,341	128,326
Shpenzime për tarifa dhe komisione		(18,270)	(52,799)
Të ardhura nga tarifat dhe komisionet, neto	24	120,071	75,527
(Shpenzime)/ te ardhura të tjera, neto	25	41,460	(58,862)
Te ardhura te tjera operative, neto	26	13,060	3,501
Të ardhura/(shpenzime) operative		54,520	(55,361)
Rimarje/(Humbje) nga zhvlerësimi i aktiveve financiare, neto	10	365,769	(2,012,434)
(Humbje)/rimarje nga zhvlerësimi i zërave jashtë bilancit, neto	18	(3,083)	646
Zhvlerësimi i inventarit	13	-	(48,818)
Shpenzime personeli	27	(394,713)	(516,093)
Shpenzime qeraje operative		(124,336)	(166,032)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	11,12	(101,854)	(132,044)
Shpenzime të tjera administrative	28	(359,503)	(476,756)
Provizione për rrezikun dhe shpenzime	18	(7,375)	(21,462)
Totali i shpenzimeve		(625,095)	(3,372,993)
Fitimi/(humbja) neto, përpara tatim fitimit		420,117	(2,709,013)
Shpenzimi i tatim fitimit	29	(716)	(918)
Fitimi/(humbja) neto e vitit		419,401	(2,709,931)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse			
Zëra që janë ose mund të riklasifikohen në pasqyrën e fitim humbjeve		-	-
Ndryshimi në vlerën e drejtë të letrave me vlerë të vendosjes, neto nga tatimi mbi fitimin		424,793	46,737
Të ardhura/(humbje) të tjera gjithëpërfshirëse për periudhën, neto		424,793	46,737
Totali i të ardhurave/(humbjeve) të tjera përmbledhëse për periudhën, neto		844,194	(2,663,194)

Shënimet shpjeguese të paraqitura në faqet 6 deri në 54 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare. Këto pasqyra financiare janë nënshkruar në emër të Bankës më 29 Mars 2017 nga:

Andi Ballta
Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv



Armand Muharremi
Drejtori Divizionit të Financës



PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL

PËR VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2016 (në mijë LEK)

	Kapitali aksionar	Rezerva ligjore	Rezerva të vlerës së drejtë	Fitimi i pa-shpërndarë	Totali
Gjendja më 1 Janar 2016	7,708,537	57,162	45,282	(5,730,448)	2,080,533
Fitimi i vitit	-	-	-	419,401	419,401
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse					
Ndryshimi në vlerën e drejtë të letrave me vlerë të vendosjes, neto	-	-	424,793	-	424,793
Totali i të ardhurave/(humbjeve) gjithëpërfshirëse	-	-	424,793	419,401	844,194
Veprime me aksionarët, të regjistruara direkt në kapital					
Kontribute të aksionarëve nëpërmjet konvertimit të detyrimeve të varura	-	-	-	-	-
Totali i kontributeve nga dhe i shpërndarjeve ndaj aksionarëve	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2016	7,708,537	57,162	470,075	(5,311,047)	2,924,727
Gjendja më 1 Janar 2015	6,961,333	57,162	(1,455)	(3,020,517)	3,996,523
Humbja e vitit	-	-	-	(2,709,931)	(2,709,931)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse					
Ndryshimi në vlerën e drejtë të letrave me vlerë të vendosjes, neto	-	-	46,737	-	46,737
Totali i të ardhurave/(humbjeve) gjithëpërfshirëse	-	-	46,737	(2,709,931)	(2,663,194)
Veprime me aksionarët, të regjistruara direkt në kapital					
Kontribute të aksionarëve nëpërmjet konvertimit të detyrimeve të varura	747,204	-	-	-	747,204
Totali i kontributeve nga dhe i shpërndarjeve ndaj aksionarëve	747,204	-	-	-	747,204
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	7,708,537	57,162	45,282	(5,730,448)	2,080,533

PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE

PËR VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2016 (në mijë LEK)

	Shënime	2016	2015
Fitimi/(Humbja) para tatim fitimit		419,401	(2,709,931)
Rregullimet për:			
Zhvierësimi dhe amortizimi	11,12	101,854	132,044
(Fitim)/humbje nga zhvierësimi i aktiveve financiare, neto	10	(365,769)	2,012,434
(Fitim)/humbje nga zhvierësimi i kredive për aktive jofinanciare, neto		-	48,818
Humbje/(fitim) nga zhvierësimi i zërave jashtë bilancit, neto	18	3,083	(646)
Humbje/(fitim) nga zhvierësimi i provizioneve të tjera operative, neto	18	7,375	21,462
Të ardhura neto nga interesat	23	(870,621)	(643,814)
Diferenca konvertimi		(16,464)	(25,741)
Nxjerrje jashtë përdorimi e aktiveve afatgjata	11,12	575	1,064
Shpenzimi i tatim fitimit	29	716	918
Ndryshimet në:			
Hua dhe paradhënie ndaj bankave	8	1,713,491	2,989,748
Rezervën e detyrueshme	8	(472,126)	(125,022)
Hua dhe paradhënie klientëve	10	(168,945)	3,325,062
Detyrimet ndaj bankave	14	754,256	(528,451)
Detyrime ndaj klientëve	15	8,541,531	2,220,834
Inventarë dhe aktive të tjera	13	48,422	307,792
Detyrime të tjera dhe provizione	18,19	209,187	(32,164)
Detyrime tatimore të shtyra	29	81,314	-
Interesi i arkëtuar		1,150,378	1,170,678
Interes i paguar		(379,839)	(365,488)
Fluksi monetar neto nga aktivitetet operative		10,757,819	7,799,597
Fluksi monetar nga aktivitetet investuese			
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	11	(39,138)	(44,123)
Blerje e aktiveve afatgjata jo materiale	12	(19,676)	(43,108)
Blerje neto të investimeve në letra me vlerë të vendosjes	9	(4,703,188)	(4,393,652)
Blerje neto të investimeve në letra me vlerë të investimit	9	(6,888,858)	-
Fluksi monetar neto i përdorur në aktivitetet investuese		(11,650,860)	(4,480,883)
Fluksi monetar nga aktivitetet financuese			
Të hyra nga rritja e detyrimeve të varura	16	-	614,109
Fluksi monetar neto nga aktivitetet financuese		-	614,109
(Pakësimi)/rritja/ neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare		(893,041)	3,932,823
Mjetet monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 Janar		4,910,984	978,161
Mjetet monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 Dhjetor	7	4,017,943	4,910,984

(TË GJITHË SHUMAT NË MIJË LEK, PËRVEÇ KUR SHPREHET NDRYSHE)

SHËNIME TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2016

1. SUBJEKTI RAPORTUES

Banka Amerikane e Investimeve SHA ("Banka" e njohur më parë si Banka Credit Agricole Shqipëri SHA), është një filial i zotëruar tërësisht nga Tranzit SHPK, një institucion financiar jo-bankar shqiptar i cili ofron disa mundësi fleksibël financimi për shoqëritë dhe individët.

Banka u krijua fillimisht si një degë e Bankës Tregtare të Greqisë (më pas e quajtur Banka Emporiki e Greqisë S.A.) në Tetor 1998. Në Tetor 1999, Banka, duke u quajtur fillimisht Intercommercial Bank - Albania Sh.A., ishte e autorizuar për të vepruar në të gjitha fushat e aktivitetit bankar. Gjatë vitit 2001 Banka ndryshoi emrin e saj në Bankën Tregtare të Greqisë (Albania) Sh.A. Më 1 Mars 2004, emri i Bankës u ndryshua në Emporiki Bank Albania Sh.A.

Në Qershor të vitit 2012, Banka Emporiki e Greqisë S.A. i shiti IUB Holding 100% të pjesëmarrjes së saj në filialin e zotëruar 100% të Emporiki Bank Albania sh.a. IUB Holding është një shoqëri anonime Franceze "par actions simplifiées", 100% filial i drejtpërdrejtë i Credit Agricole S.A. Në 3 Shtator 2012 emri i bankës ndryshoi në Banka Credit Agricole Shqipëri Sh.A. Në Tetor 2015, IUB Holding shiti 100% të pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të filialit të saj, Banka Credit Agricole Shqipëri Sh.A, tek Tranzit Sh.p.k. Miratimet e Rregullatorit, duke përfshirë dhe ndryshimin e emrit në Banka Amerikane e Investimeve SHA, u finalizuan me efekt ligjor në datën 12 Tetor 2015. Banka operon në përputhje me Ligjin Nr. 9662 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" të datës 18 Dhjetor 2006. Banka është e licencuar për të kryer aktivitetet e kreditimit dhe depozitimit, shërbimet e pagesave në Shqipëri dhe jashtë saj si dhe aktivitetet e tjera bankare në përputhje me ligjet Shqiptare.

Në 31 Dhjetor 2016, kapitali i regjistruar aksionar ishte Lek 7,708,537 mijë i përbërë nga EUR 9,998 mijë dhe Lek 6,309,426 mijë (2015: Lek 7,708,537 i përbërë nga EUR 29,433 mijë dhe Lek 3,690,659 mijë) të ndarë në 68,423 aksione të përbërë nga 56,111 aksione me vlerë nominale prej Lek 112,445.54 dhe 12,312 aksione me vlerë nominale prej EUR 812.08 (2015: 68,423 aksione të përbërë nga 32,179 aksione me vlerë nominale prej Lek 114,691.54 dhe 36,244 aksione me vlerë nominale prej EUR 812.08).

Zyra Qëndrore e Bankës është e vendosur në Tiranë në Rrugën e Kavajës, Godina 27 kati 8 hyrja 1. Banka operon vetëm në Shqipëri me një rrjet prej 19 degësh më 31 Dhjetor 2016 (2015: 19 degë) Gjashtë degë janë të vendosura në Tiranë dhe degët e tjera janë të vendosura në Durrës, Kavajë Lushnjë, Elbasan, Fier, Vlorë Gjirokastrë, Sarandë, Korçë, Lezhë dhe Shkodër, e ndjekur nga 2 agjenci në Portin e Durrësit dhe Livadhja.

Banka ka 243 të punësuar më 31 Dhjetor 2016 (2015: 252), nga të cilët 147 (2015: 156) janë të punësuar në Zyrën Qëndrore.

2. BAZAT E PËRGATITJES

(a) Deklaratë për përputhshmërinë rregullative

Në përputhje me legjislacionin kontabël vendas, pasqyrat financiare janë përgatitur sipas standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të vendosura nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

(b) Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me parimin e kostos historike, me përjashtim të aktiveve financiare të letrave me vlerë të vendosjes, të cilat janë të matura me vlerën e drejtë.

(c) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare janë të raportuara në Lek, e cila është edhe monedha funksionale dhe raportuese e Bankës. Me përjashtim të rasteve të specifikuar, informacioni financiar i shprehur në Lek është rrumbullakosur në të miltën më të afërt.

3. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL

a) Transaksione në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të vlefshëm në datën e transaksioneve. Aktivitetet dhe detyrimet monetare të shprehura në monedhë të huaj në datën e raportimit janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të vlefshëm në atë datë. Fitimi ose humbja nga kursi i këmbimit mbi zërat monetarë është

diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostos së amortizueshme në monedhë të huaj të këmbyer me kursin e këmbimit të fundvitit.

Aktivet dhe detyrimet jo-monetare të matura me vlerën e drejtë në monedhë të huaj këmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e përcaktimit të vlerës së drejtë. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare të matura me koston historike në monedhë të huaj këmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat nga kurset e këmbimit në përgjithësi njihen në pasqyrën e të ardhurave.

b) Interesat

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat njihen në fitim ose humbje me anë të metodës së interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që skanton saktësisht pagesat dhe arkëtimet të pritshme në të ardhmen përgjatë jetëgjatësisë së pritshme të aktivitetit ose detyrimit financiar (ose, kur është e përshtatshme, për një periudhë më të shkurtër) në vlerën kontabël të aktivitetit ose detyrimit financiar. Për llogaritjen e normës efektive të interesit, Banka vlerëson rrjedhën e parasë në të ardhme duke marrë në konsideratë të gjitha kushtet kontraktuale të instrumenteve financiare, por jo humbjet nga kredia në të ardhmen.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha tarifatat e paguara ose të marra që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit. Kostot e transaksionit përfshijnë shpenzime shtesë të lidhura drejtpërdrejtë me blerjen ose emetimin e një aktivi ose detyrimi financiar.

c) Tarifatat dhe komisionet

Të ardhurat dhe shpenzimet nga komisionet që janë pjesë integrale e normës efektive të interesit të një aktivi ose detyrimi financiar përfshihen në përcaktimin e normës efektive të interesit.

Të ardhura dhe shpenzime të tjera nga tarifa dhe komisione lindin nga shërbime financiare të kyera nga Banka dhe njihen në momentin kur shërbimi respektiv është ofruar ose përfituar.

d) Pagesat e bëra për qiranë

Pagesat e kryera për qiratë operative janë njohur në fitim ose humbje mbi baza lineare përgjatë afatit të qirasë. Zbritje të marra nga qiraja njihen si një pjesë përbërëse e shpenzimeve totale të qirasë, gjatë kohëzgjatjes së saj.

e) Shpenzime për tatimet

Shpenzimet për tatimin mbi fitimin përfshijnë tatimin afatshkurtër dhe tatimin e shtyrë. Tatimi afatshkurtër

dhe tatimi i shtyrë njihen në pasqyrën e të ardhurave me përjashtim kur i referohet zërave të cilët njihen direkt në kapital ose tek të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse.

(i) Tatimi aktual

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet ose të arkëtohet për të ardhurat e tatueshme ose shpenzimet për periudhën, dhe çdo rregullim të tatimit që duhet të paguhet ose të arkëtohet në lidhje me vitet e mëparshme. Shuma e tatimit aktual e pagueshme ose e arkëtueshme është vlerësimi më i mirë i shumës së tatimit që pritet të paguhet ose të arkëtohet që reflekton pasiguri lidhur me tatimet mbi të ardhurat, nëse ka. Ajo matet duke përdorur normën tatimore në fuqi ose të miratuar parimisht në datën e raportimit.

(ii) Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë përllogaritet mbi diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël të mbetur të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vlerës së përdorur për qëllime fiskale. Tatimi i shtyrë nuk njihet për diferencat e përkohshme në njohjen fillestare të aktiveve ose detyrimeve në një transaksion që nuk është kombinim biznesi dhe nuk ndikon as në kontabilitet as në fitimin ose humbjen e tatueshme.

Aktivet tatimore të shtyra njihen mbi humbjet tatimore të mbartura, të drejtat tatimore të mbartura dhe diferencat e përkohëshme të zbritshme duke konsideruar fitime të ardhshme të tatueshme, kundrejt të cilave të mund të përdoren. Aktivet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen në masën që nuk është më i mundur realizimi i përfitimit tatimor respektiv; reduktimet e tilla sistemohen, kur probabiliteti i fitimit të tatueshëm në të ardhmen përmirësohet.

Aktivet tatimore të shtyra të panjohura rivlerësohen në çdo datë raportimi dhe njihen deri në masën e fitimit të ardhshëm të tatueshëm që do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit ato mund të përdoren.

Tatimi i shtyrë llogaritet me normat tatimore që priten të aplikohen ndaj diferencave të përkohshme në momentin e rimarrjes, duke përdorur normat tatimore në fuqi ose që hyjnë në fuqi në datën e raportimit.

(iii) Ekspozimi tatimor

Në përcaktimin e vlerës së tatimit aktual dhe të shtyrë, Banka merr parasysh ndikimin e pozicioneve të pasigurta tatimore dhe nëse duhet të paguhet tatime dhe interesa shtesë. Ky vlerësim mbështetet në vlerësimet dhe supozimet dhe mund të përfshijë një sërë gjykimesh për ngjarje të ardhshme. Të dhëna të reja mund të bëhen të disponueshme të cilat mund të shkaktojnë që Banka të ndryshoj gjykimin e saj në lidhje me mjaftueshmërinë e detyrimeve tatimore aktuale; këto ndryshime në

detyrimet tatimore do të ndikojnë shpenzimet tatimore të periudhës kur një konstatim/përcaktim i tillë është bërë.

f) Aktivet dhe detyrimet financiare

(i) Njohja dhe matja fillestare

Banka fillimisht njihet huatë dhe paradhëniet, depozitat, letrat me vlerë të borxhit, të emetuara dhe detyrimet e varura në datën kur ato janë krijuar. Blerjet dhe shitjet e rregullta të aktiveve financiare njihen në datën e tregtimit kur banka angazhohet për blerjen ose shitjen e aktivitetit. Të gjitha aktivet dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit në të cilën Banka bëhet palë për respektimin e dispozitave kontraktuale të instrumentit. Aktiviteti ose detyrimi financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot e transaksionit të cilat lidhen direkt me blerjen ose emetimin e tij.

(ii) Klasifikimi

Aktiviteti financiar

Banka i klasifikon aktivet e saj financiare në një nga kategoritë e mëposhtme:

- Hua dhe të arkëtueshme;
- Të mbajtura deri në maturim; ose
- Të vlefshme për shitje.

Shikoni politikat kontabël 3 (h dhe i)

Detyrimet financiare

Banka i klasifikon detyrimet e saj financiare, përveç si garanci financiare dhe angazhime të huasë, si të matura me koston e amortizuar. Shikoni politikat kontabël 3.n.

(iii) Çregjistrimi

Aktiviteti financiar

Banka çregjistron një aktiv financiar nëse të drejtat kontraktuale mbi flukset monetare nga aktiviteti financiar mbarojnë ose kur transferon të drejtat për të përfituar flukset monetare kontraktuale nga aktiviteti financiar me një transaksion nëpërmjet të cilit transferohen në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivitetit financiar. Çdo interes në aktivitetin financiar të transferuar që krijohet ose mbahet nga Banka njihet si një aktiv ose detyrim më vete.

Banka kryen transaksione nëpërmjet të cilave transferon aktivet e njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por mban të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivitetit të transferuar ose një pjesë të tyre. Nëse të gjitha ose në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet janë mbajtur, atëherë aktivet e transferuara nuk çregjistrohen. Transferime të aktiveve për të cilat mbahen një pjesë e mirë ose të gjitha rreziqet dhe përfitimet, përfshijnë huadhënien e letrave me vlerë dhe marrëveshjet e riblerjes. Përsa i përket transaksioneve ku Banka nuk

mban dhe as transferon në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe përfitimet që rrjedhin nga pronësia mbi aktivitetin financiar, ajo e çregjistron aktivitetin kur nuk mban kontrollin mbi të. Të drejtat dhe detyrimet të cilat mbahen gjatë transferimit njihen veçmas si aktive dhe si detyrime, sipas rastit. Në transferime, ku ruhet kontrolli mbi aktivitetin, Banka vazhdon të njohë aktivitetin në masën e përfshirjes së vazhdueshme, e përcaktuar nga masa në të cilën ajo është e ekspozuar ndaj ndryshimeve në vlerën e aktivitetit të transferuar.

Në disa transaksione Banka ruan detyrimin të shërbejë ndaj aktivitetit financiar të transferuar kundrejt një komisioni. Aktiviteti i transferuar çregjistrohet në tërësi nëse plotësohen kriteret e çregjistrimit. Një aktivitet ose detyrim njihet kundrejt kontratës së shërbimit, në varësi të faktit nëse tarifa e shërbimit, për kryerjen e shërbimit është më shumë se mjaftueshëm (aktiv) ose është më pak se mjaftueshëm. Banka fshin kredi të caktuara - kur ato konsiderohen si të pambledhshme (shikoni notën 5.a).

Detyrimet financiare

Banka çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale të tij janë shfuqizuar, anuluar ose kur ju ka mbaruar afati.

(iv) Kompensimi

Aktiviteti dhe detyrimet financiare kompensohen dhe vlera neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur Banka gëzon të drejtën ligjore për të bërë kompensimin e vlerave, dhe ka si qëllim ose të shlyejë mbi një bazë neto ose të realizojë aktivitetin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten neto vetëm nëse lejohen nga standardet e kontabilitetit, ose për fitime apo humbje të cilat rezultojnë nga realizimi i një grupi transaksionesh të ngjashme në aktivitetin tregtar të Bankës.

(v) Matja me kosto të amortizuar

Kosto e amortizueshme e aktivitetit ose detyrimit financiar është shuma me të cilën aktiviteti dhe detyrimi financiar matet në fazën e njohjes fillestare minus pagesat e principalit, minus ose plus vlerën e amortizimit të akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo ndryshim midis shumës fillestare që është njohur dhe shumës në maturim, minus çdo humbje nga zhvlerësimi.

(vi) Matja me vlerën e drejtë

Vlera e drejtë është çmimi që do të merrej për të shitur një aktivitet ose paguhej për të transferuar një detyrim, në një transaksion të zakonshëm ndërmjet palëve pjesëmarrëse të tregut në datën e matjes, në tregun kryesor ose, në mungesë të tij, në tregun më të favorshëm në të cilin Banka ka akses në këtë datë. Vlera e drejtë e një detyrimi pasqyron rrezikun e mos-performancës së tij.

Kur janë të disponueshme, Banka mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmime të publikuara në një treg aktiv për instrumentin. Një treg konsiderohet aktiv nëse transaksionet mbi aktivet dhe detyrimet kanë frekuencë dhe vlera të mjaftueshme për të siguruar informacion mbi çmimet e kuotuar të tregut në mënyrë të vazhdueshme. Nëse nuk ekziston një çmim i kuotuar në një treg aktiv, atëherë Banka përdor teknika vlerësimi që maksimizojnë përdorimin e të dhënave të vëzhgueshme dhe minimizojnë përdorimin e të dhënave të paverifikueshme. Teknika e zgjedhur e vlerësimit konsideron të gjithë faktorët që aktorët e tregut do të konsideronin në vendosjen e çmimit.

Evidenca më e mirë e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar në momentin e njohjes fillestare është çmimi i transaksionit, pra vlera e drejtë e shumës së marrë apo dhënë. Nëse Banka përcakton se vlera e drejtë në momentin e njohjes fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit dhe nuk është përcaktuar as duke përdorur një çmim të kuotuar në një treg aktiv për një aktiv ose pasiv të ngjashëm as nuk bazohet në një teknikë vlerësimi që përdor vetëm të dhëna nga tregje të mbikëqyrura, atëherë instrumenti financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë, rregulluar për të shtyrë diferencën midis vlerës së drejtë në momentin e njohjes fillestare dhe çmimit të transaksionit. Më pas, kjo do të njihet në fitim ose humbje në një bazë të përshtatshme përgjatë jetës së instrumentit, por jo më vonë se momenti kur vlerësimi mbështetet plotësisht në të dhëna të identifikueshme të tregut apo transaksioni mbyllet.

Aktivitet dhe pozicionet e gjata në blerje maten me çmimin ofertë; detyrimet dhe pozicionet e shkurtra në shitje maten me çmim kërkesë.

Vlera e drejtë e një depozite pa afat nuk është më pak se shuma e pagueshme sipas kërkesës, skontuar nga data e parë në të cilën do të mund të kërkohej shuma për t'u paguar.

Banka nje transferimet ndërmjet niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë në fund të periudhës raportuese në të cilën ka ndodhur ndryshimi.

(vii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimeve

Në çdo datë raportimi Banka vlerëson nëse ka fakte objektive që aktivet financiare janë të zhvlerësuar. Aktivet financiare ose një grup i aktiveve financiare zhvlerësohen kur faktet objektive tregojnë që një ngjarje humbjeje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit dhe që kjo ngjarje humbjeje ka një ndikim në flukset e ardhshme monetare nga ky aktiv që mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme.

Evidenca objektive që aktivet financiare janë zhvlerësuar

mund të përfshijnë mospërbushje e detyrimeve ose shkelje të detyrimeve nga huamarrësi, ristrukturimin e një huaje ose paradhënie nga Banka me kushte që në të kundërt Banka nuk do të konsideronte treguesit që një huamarrës ose huadhënës po falimenton, humbjen e një tregu aktiv të letrave me vlerë, ose të dhëna të tjera në lidhje me një grup aktivësh si ndryshimet jo të favorshme në statusin e pagesës së huamarrësve dhe emetuesve në grup, ose kushtet ekonomike të cilat lidhen me mospërbushjen e detyrimeve në grup.

Banka konsideron evidencën për zhvlerësimin e kredive dhe paradhënies si në nivel individual ashtu edhe në nivel grupi. Të gjitha kreditë individualisht të rëndësishme vlerësohen për zhvlerësim specifik. Të gjitha kreditë dhe paradhëniet individualisht të rëndësishme, por jo të zhvlerësuar në mënyrë specifike, vlerësohen në grup për çdo zhvlerësim të ndodhur, por të paidentifikuar ende. Kreditë dhe paradhëniet, të cilat nuk janë individualisht të rëndësishme, vlerësohen në grup për zhvlerësim, duke grupuar së bashku investime në letra me vlerë të kredive dhe paradhënies me karakteristika të ngjashme rreziku. Në përcaktimin e zhvlerësimit në nivel grupi Banka aplikon si minimum trendet historike të normave rregullatore të paracaktuara, kohën e rekuperimit dhe shumën e humbjeve të ndodhura për secilin grup homogjen të huave dhe paradhënies bazuar në fakte objektive të zhvlerësimit. Normat e paracaktuara dhe periudha e pritshme e rekuperimeve të ardhshme krahasohen rregullisht me rezultatet aktuale për të siguruar që ato të mbeten të përshtatshme.

Humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve të mbajtura me kosto të amortizuar, maten si diferencë midis vlerës kontabël të aktivitetit financiar dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshëm, të skontuara me normën fillestare të interesit efektiv. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje dhe pasqyrohen në një llogari zbritje kundrejt kredive, parapagimeve ose investimeve në letra me vlerë të mbajtura deri në maturim. Kur një ngjarje e evidentuar pas njohjes së zhvlerësimit shkakton uljen e vlerës së zhvlerësimit, ulja në humbjen nga zhvlerësimi rimerret nëpërmjet fitimit dhe humbjes.

Humbje nga zhvlerësimi investimeve në letra me vlerë të vlefshme për shitje, nesë ka, njihen duke ri-klasifikuar humbjet e akumuluar nga rezerva e vlerës së drejtë nga llogaritë e kapitali në fitim dhe humbje. Humbja e akumuluar e ri-klasifikuar nga kapitali në fitim ose humbje, është diferenca midis koston së blerjes, neto nga ndonjë pagesë principali apo amortizimi, dhe vlerës së drejtë aktuale, të pakësuar për humbje nga zhvlerësime të njohura më parë në fitimi ose humbje. Ndryshime në provizionet për zhvlerësim që lidhen me

aplikimin e normës efektive të interesit paraqiten si pjesë e të ardhurës nga interesi. Nëse në një periudhë pasuese, vlera e drejtë e një letre me vlerë të vlefshme për shitje, të zhvlerësuar, rritet, dhe kjo rritje mund të lidhet objektivist me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi, atëherë humbja nga zhvlerësimi rimeret nëpërmjet llogarisë së rimarjes në fitim humbje. Sidoqoftë, çdo rikuperim i mëtejshëm në vlerën e drejtë të një letre me vlerë kapitali, të vlefshme për shitje, të zhvlerësuar njihet në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse.

g) Mjete monetare dhe të ngjashme

Mjete monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë mjetet në arkë, llogaritë me bankën qendrore, investime afatshkurtra shumë likuide me maturitet fillestar 3 muaj ose më pak nga data e blerjes që janë subjekt i një rreziku të papërfillshëm të ndryshimeve në vlerën e drejtë, dhe përdoren nga Banka në administrimin e angazhimeve afatshkurtra.

h) Hua dhe paradhënie dhënë klientëve

Huatë dhe paradhëniet ndaj klientëve janë aktive financiare jo derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara që nuk janë të kuotuar në një treg aktiv dhe Banka nuk ka për qëllim shitjen e tyre të menjëhershme ose në një kohë të afërt.

Kur Banka blen një aktiv financiar dhe në të njëjtën kohë nënshkruan një marrëveshje ri-shitjeje të aktivitetit (ose të aktiveve të ngjashme) me një çmim fiks në një datë të ardhshme ("marrëveshje e anasjelltë ri-blejeje" ose "huamarrje aksionesh"), marrëveshja kontabilizohet si kredi ose paradhënie dhe aktivi në fjalë nuk njihet në pasqyrat financiare të Bankës.

Huatë dhe paradhëniet maten fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot shtesë direkte me transaksionin dhe më pas maten me koston e amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

i) Investime në Letra me Vlerë

Investimet në letra me vlerë njihen në fillim me vlerën e drejtë plus kostot shtesë direkte të lidhura me transaksionin, dhe më pas kontabilizohen në varësi të klasifikimit të tyre si: të mbajtura deri në maturim ose të vlefshme për shitje.

(i) Të mbajtura deri në maturim

Investimet e mbajtura deri në maturim janë aktive financiare jo derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara dhe me maturitete fikse që Banka ka qëllimin dhe mundësinë t'i mbajë deri në maturim dhe që nuk klasifikohen si të gatshme për shitje. Investimet e mbajtura deri në maturim maten me koston e amortizuar nëpërmjet metodës së interesit efektiv.

Çdo shitje apo riklasifikim i një shume të rëndësishme të investimeve të mbajtura deri në maturim, jo afër maturimit të tyre, do të rezultonte në riklasifikimin e instrumentave të mbajtur deri në maturim si të vlefshme për shitje dhe do ta ndalonte Bankën t'i klasifikojë ato si investime në letra me vlerë të mbajtura deri në maturim për vitin ushtrimor aktual dhe dy vitet ushtrimore të ardhshëm.

(ii) Investimet të vlefshme për shitje

Investimet të vlefshme për shitje janë instrumente jo derivative të cilat nuk klasifikohen në ndonjë kategori tjetër të aktiveve financiare. Letrat me vlerë të pakuotuar të kapitalit, vlera e drejtë e të cilave nuk mund të matet në mënyrë të besueshme, mbahen me kosto. Të gjitha investimet e tjera të vlefshme për shitje mbarten me vlerën e drejtë.

Të ardhurat nga interesi njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv. Fitimet ose humbjet nga kursi i këmbimit të investimeve në letra me vlerë të borxhit të vlefshme për shitje njihen në fitim ose humbje. Ndryshime të tjera të vlerës së drejtë njihen drejtpërdrejtë në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse deri kur investimi të jetë shitur ose zhvlerësuar dhe fitimi ose humbja e akumuluar e njohur më përpara në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, riklasifikohet në fitim ose humbje.

Investimet e vlefshme për shitje mund të riklasifikohen nga kategoria të vlefshme për shitje, në kategorinë të mbajtura deri në maturim në qoftë se plotësojnë përkufizimin si të mbajtura deri në maturim dhe nëse banka ka synimin dhe aftësinë për të mbajtur atë aktiv financiar për një të ardhme të parashikueshme, ose deri në maturim.

j) Aktivët Afatgjata Material

(i) Njohja dhe matja

Aktivët afatgjata materiale maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi. Kostot përfshijnë të gjitha shpenzimet të cilat lidhen drejtpërdrejtë me blerjen e aktivitetit. Nëse pjesë të një aktiviteti afatgjatë material kanë jetë të dobishme të ndryshme, atëherë këto pjesë kontabilizohen si zëra të veçanta (përbërësit kryesor) të aktiveve afatgjata materiale. Çdo fitim ose humbje nga shitja/nxjerrja jashtë përdorimit e një aktiviteti afatgjatë material (të llogaritur si diferenca midis të ardhurave neto nga shitja e aktivitetit dhe vlera kontabël të aktivitetit) njihet tek të ardhurat e tjera në fitim ose humbje.

(ii) Kosto të tjera pasuese

Kostot e zëvendësimit të një pjese të aktiviteti afatgjatë material njihen me vlerën kontabël të aktivitetit nëse është e mundur që përfitime të ardhshme ekonomike që lidhen me këtë aktivitet do të rrjedhin për Bankën dhe nëse kostot

e tij mund të maten në mënyrë të besueshme.

(iii) Zhvlerësimi

Zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje duke përdorur metodën lineare përgjatë jetës së dobishme të vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material. Trualli dhe veprat e artit nuk zhvlerësohen. Jeta e dobishme e vlerësuar për periudhën aktuale janë të paraqitura si më poshtë:

	(në vite)
• Ndërtesa	40
• Mobilje dhe pajisje zyre	5
• Automjete	5
• Përmirësimet e ambienteve të marra me qira	9 - 12
• Kompjuterat dhe pajisjet elektronike	4 - 5

Aktivitetet nuk amortizohen deri në momentin që fillojnë të përdoren dhe transferohen nga aktive në ndërtim apo zhvillim, në kategorinë përkatëse të aktiveve.

k) Aktivitetet afatgjata jomateriale

Aktivitetet afatgjata jomateriale paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe çdo humbje nga zhvlerësimi. Amortizimi llogaritet duke përdorur metodën lineare përgjatë jetës së dobishme të vlerësuar të aktivitetit. Jeta e dobishme e vlerësuar paraqitet si më poshtë:

	(në vite)
• Programe dhe aplikacione të teknologjisë informative	4 - 10

l) Inventari i aktiveve të marra në zotërim

Inventari përfshin aktivitetet e marra në zotërim nëpërmjet ekzekutimit të garancisë mbi kreditë me probleme dhe paradhëniet ndaj klientëve, të cilat, nuk janë dhënë me qira, nuk janë në përdorim nga Banka dhe janë planifikuar të shiten brenda një periudhe të shkurtër të arsyeshme, pa qënë objekt ristrukturimi të rëndësishëm. Aktivitetet e marra në zotërim maten me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme si dhe të gjitha fshirjet e inventarit paraqiten në fitim ose humbje.

m) Zhvlerësimi i aktiveve jo financiare

Vlera kontabël e mbetur e aktiveve jo financiare të Bankës, të ndryshme nga aktivitetet tatimore të shtyra dhe inventarët, rishikohet çdo datë raportimi, për të përcaktuar nëse ka tregues të zhvlerësimit. Nëse ka tregues të tillë atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur kontabël e aktivitetit ose e njësisë gjeneruese të mjetëve monetare tejkalon vlerën e rikuperueshme të aktivitetit. Një njësi gjeneruese e mjetëve monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve i cili gjeneron flukse monetare, të cilat në masë të madhe janë të pavarura nga aktivitetet e tjera ose grupet e tjera të aktiveve. Humbjet nga zhvlerësimi janë njohur në fitim

ose humbje. Humbjet nga zhvlerësimi të njohura në lidhje me njësitë gjeneruese të mjetëve monetare alokohen fillimisht për të pakësuar vlerën kontabël të emrit të mirë të alokuar kësaj njësie gjeneruese të mjetëve monetare dhe më pas për të ulur vlerën kontabël të aktiveve të tjera të njësisë gjeneruese të mjetëve monetare (grup njësisë gjeneruese të mjetëve monetare), me bazë të ponderuar. Vlera e rikuperueshme e një aktiviteti ose e njësisë gjeneruese të mjetëve monetare është më e madhja midis vlerës së tij në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e vlerësuarat monetare të ardhshme janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivitetin.

n) Depozitat

Depozitat përbëjnë burimet kryesore të financimit të Bankës.

Kur Banka shet një aktiv financiar dhe në të njëjtën kohë nënshkruan një marrëveshje për riblerjen e aktivitetit (ose të një aktiviteti të ngjashëm) me çmim fiks në një datë të ardhshme ("repo" ose "huamarrje aktive") marrëveshja kontabilizohet si depozitë, dhe aktiviteti në fjalë vazhdon të njihet në pasqyrat financiare të Bankës.

Banka klasifikon instrumentat e kapitalit si detyrime financiare ose instrumente kapitali në përputhje me kushtet kontraktuale të instrumentit. Depozitat dhe detyrimet e varura fillimisht maten me vlerën e drejtë plus kostot shtesë direkte të transaksionit, dhe më pas maten me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit, me përjashtim kur Banka vendos të mbart detyrimet me vlerën e drejtë përmes fitim ose humbjes.

o) Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje në të kaluarën, Banka ka një detyrim ligjor ose konstruktiv dhe ka të ngjarë të ketë një dalje të burimeve ekonomike për shlyerjen e detyrimit. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme monetare me një normë para tatimit e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe aty ku është e përshtatshme, edhe rreziqet specifike të detyrimit.

p) Përfitimet e punonjësve

Banka paguan vetëm kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore të cilat përfitohen nga punonjësit pas daljes në pension. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributësh të përcaktuara. Kontributet e Bankës për planin e pensionit ngarkohen në fitim ose humbje në momentin kur ato ndodhin.

4 | STANDARDET E REJA DHE INTERPRETIME ENDE TË PA MIRATUARA

Një numër standardesh të reja, ndryshime të standardeve dhe interpretimeve kanë hyrë në fuqi për periudhat vjetore duke filluar pas datës 1 Janar 2016, Megjithatë Banka nuk ka aplikuar standardet e reja ose të ndryshuara për përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare.

Standardet e reja ose të ndryshuara	Përmbledhje e kërkesave	Ndikimi i mundshëm në pasqyrat financiare
<p>SNRF 9 Instrumentet Financiare</p>	<p>SNRF 9, publikuar në Korrik 2014, zëvendëson udhëzimin ekzistues të SNK 39 Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja. SNRF 9 paraqet udhëzime të rishikuara për klasifikimin dhe matjen e instrumenteve financiare, duke përfshirë një model të ri të humbjes së pritshme të kredisë për llogaritjen e zhvlerësimit të aktiveve financiare, dhe kriteret e reja të përgjithshme të kontabilitetit mbrojtës. Standardi gjithashtu mbarë udhëzime për njohjen dhe mos-njohjen e instrumenteve financiare nga SNK 39.</p> <p>SNRF 9 hyn në fuqi për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë në dhe pas datës 1 Janar 2018, duke lejuar dhe aplikimin paraprak.</p>	<p>Banka është duke vlerësuar ndikimin e mundshëm në pasqyrat e saj financiare që rezultojn nga zbatimi i SNRF9. Pritet që llogaritja e zhvlerësimit të instrumenteve financiare në bazë të humbjes së pritshme nga kredia do të sjellë rritjen e nivelit të përgjithshëm të provizioneve për zhvlerësimin.</p> <p>Banka është në proces të krijimit të politikave dhe procedurave për të vlerësuar ndikimin e mundshëm që do të ketë aplikimi i SNRF 9 në pasqyrat e saj financiare.</p>
<p>SNRF 15 Të ardhurat nga kontratat me klientët</p>	<p>SNRF 15 përcakton kuadrin gjithëpërfshirës për të përcaktuar masën e të ardhurave dhe kohën e njohjes së tyre. Parimi kryesor në këtë kuadër është se një kompani duhet të njohë të ardhurat për të përshkruar transferimin e mallrave ose shërbimeve të premtuara të klientit deri në shumën për të cilën kompania pret që të ketë të drejtë në këmbim të këtyre mallrave ose shërbimeve.</p> <p>SNRF 15 zëvendëson standardin ekzistues për njohjen e të ardhurave, duke përfshirë SNK 18 Të ardhurat, SNK 11 Kontratat e Ndërtimit KIRFN 13 Programet e Besnikërisë së Klientit.</p> <p>SNRF 15 hyn në fuqi për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë në dhe pas datës 1 Janar 2018, duke lejuar dhe aplikimin paraprak.</p>	<p>Edhe pse ende nuk ka përfunduar plotësisht vlerësimin fillestar të ndikimit të mundshëm të SNRF 15 në pasqyrat financiare të Bankës, menaxhimi nuk pret që standardi i ri, në aplikimin fillestar, të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të Bankës. Koha dhe matja e të ardhurave të bankës nuk pritet të ndryshojë në bazë të SNRF 15 për shkak të natyrës së operacioneve të Bankës dhe të llojit të të ardhurave që gjeneron.</p>

Standarde të reja ose të ndryshuara	Përmbledhje e kërkesave	Ndikimi i mundshëm në pasqyrat financiare
<p>SNRF 16 Qiratë</p>	<p>SNRF 16 Qiratë, publikuar nga BSNK në Janar 2016 zëvendëson SNK 17 Qiratë. SNRF 16 përcakton parimet për njohjen, matjen, prezantimin dhe paraqitjen e qirave. Objektivi është të sigurojë që qiramarrësi dhe qiradhënësi të sigurojnë informacionin e rëndësishëm që paraqesin në mënyrë të drejtë këto transaksione. Ky informacion u siguron përdoruesve të pasqyrave financiare bazën për të vlerësuar ndikimin e qirave në pozicionin financiar, ecurinë financiare dhe rrjedhën e parasë së entitetit.</p> <p>Standardi paraqet një model kontabël të një qiramarrësi të vetëm, sipas të cilit qiramarrësve u kërkohet të njohin aktivet dhe detyrimet për të gjitha qiratë, nëse afati i qirasë nuk është 12 muaj ose më i shkurtër, ose aktivi në fjalë ka një vlerë të vogël. Qiradhënësit vazhdojnë të klasifikojnë qiratë si operative ose financiare, sipas metodës së SNRF 16 në bazë të të cilës kontabilizimi nga qiradhënësi mbetet i pandryshuar nga standardi i mëparshëm, SNK 17.</p> <p>SNRF 16 hyn në fuqi për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë në ose pas datës 1 Janar 2019, duke lejuar dhe aplikimin paraprak.</p>	<p>Banka është duke vlerësuar ndikimin e mundshëm në pasqyrat financiare të saj që rezulton nga zbatimi i SNRF 16. SNRF 16 heq klasifikimin e qirave si qira financiare ose operacionale për qiramarrësin. Në vend të saj, të gjitha qiratë trajtohen në të njëjtën mënyrë si qiratë financiare të cilat aplikojnë SNK 17. Qiratë kapitalizohen duke njohur vlerën aktuale të pagesave të qirasë dhe duke i paraqitur ato si aktive me qira (të drejtë përdorimi) ose së bashku me aktivet afatgjatë material. Nëse pagesat e qirasë kryhen më kohë të ndryshme, Banka njeh gjithashtu detyrimin financiar i cili përfaqëson detyrimin e saj për të kryer pagesa qiraje në të ardhmen. Ndikimi më i rëndësishëm i kërkesave të reja të SNRF 16, do të jetë rritja e aktiveve të qirasë dhe detyrimeve financiare</p>

Standardet e tjera të ndryshuara që nuk priten të kenë një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Bankës janë:

- Iniciativat për dhënien e informacionit (Ndryshime në SNK 7);
- Njohja e aktiveve tatimore të shtyra për Humbjet e Parezalizuara (Ndryshime në SNK 12);
- Klasifikimi dhe matja e transaksioneve të pagesave bazuar në aksione (Ndryshime në SNRF 2);
- Investimet në shitjen dhe blerjen e aktiveve midis investuesit dhe filialeve të tij ose sipërmarrjes së përbashkët (Ndryshime në SNRF 10 dhe SNK 28);
- Zbatimi i SNRF 9 Instrumentet Financiare me SNRF 4 Kontratat e Sigurimit (Ndryshime në SNRF 4);
- KIRFN Interpretimi 22 Transaksionet e Këmbimit Valutor dhe Pagesat Paraprake;
- Transferimi i aktiveve materiale afatgjata të investuara (Ndryshime në SNK 40);
- Përrjashtimet e vjetra për zbatuesit për herë të parë të SNRF janë hequr (Ndryshime në SNRF 1);
- Kërkesat për dhënien e informacioneve shpjegues mbi interesat në entitetet e tjera zbaohen gjithashtu edhe për interesat që klasifikohen si të mbajtura deri në maturim ose për tu shpërndarë (Ndryshime në SNRF 12);
- Opsionet e matjes për investimet në pjesëmarrje ose investimet në sipërmarrje të përbashkëta nëpërmjet organizatave me kapital të përbashkët ose njësi të tjera biznesi të kualifikuara (Ndryshime në SNK 28).

5 | MENAXHIMI I RREZIKUT

Përdorimi i instrumentave financiarë e ekspozon Bankën ndaj rreziqeve të mëposhtme:

- rreziku i kredisë
- rreziku i likuiditetit
- rreziku i tregut
- menaxhimi i kapitalit

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Bankës ndaj çdo rreziku të përmendur më lart, objektivat e Bankës, politikat dhe proceset e Bankës për vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut, dhe menaxhimin e kapitalit të Bankës.

Kuadri i administrimit të rrezikut

Bordi i Drejtorëve ka përgjegjësi për vendosjen dhe për mbikëqyrjen e kuadrit të menaxhimit të rrezikut të Bankës. Bordi ka krijuar Komitetin e Aktiveve dhe Detyrimeve (ALCO), Komitetin e Rrezikut të Kredisë dhe Çështjeve Sensitive (SAC) dhe komitetin e Provizionimit të cilët kanë përgjegjësi për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të menaxhimit të rrezikut të Bankës në fushat e tyre specifike. Të gjithë komitetet e Bordit kanë anëtarë ekzekutivë dhe jo ekzekutivë dhe raportojnë rregullisht tek Bordi i Drejtorëve për aktivitetet e tyre.

Politikat e menaxhimit të rrezikut të Bankës janë hartuar që të evidentojnë dhe të analizojnë rreziqet që hasen nga Banka, që të vendosin limite dhe kontrole të përshtatshme për rreziqet, dhe që të monitorojnë rreziqet dhe zbatimin e kufijve. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të pasqyruar ndryshimet në kushtet e tregut, produktet dhe shërbimet e ofruara.

Banka, përmes standardeve dhe procedurave të trajnimit dhe të menaxhimit synon të zhvillojë një mjedis kontrolli të disiplinuar dhe të strukturuar, ku të gjithë punonjësit të kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre.

Komiteti i Kontrollit të Bankës ka përgjegjësi për monitorimin e përputhshmërisë me politikat dhe procedurat e menaxhimit të rrezikut të Bankës dhe për rishikimin e mjaftueshmërisë së kuadrit të menaxhimit të rreziqeve të hasura nga Banka. Komiteti i Kontrollit

të Bankës asistohet në këto funksione nga Kontrolli i Brendshëm. Kontrolli i Brendshëm kryen rishikime të rregullta dhe të posaçme të kontrollit dhe procedurave të menaxhimit të rrezikut, rezultatet e të cilave i raportohen Komitetit të Auditit.

(a) Rreziku i kredisë

Gjatë aktivitetit normal të saj, Banka ekspozohet ndaj rrezikut të kredisë nga huatë dhe paradhëniet ndaj klientëve dhe institucioneve financiare, nga investimet në letra me vlerë dhe në zëra të tjerë jashtë bilancit. Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare të Bankës në rast se huamarrësi ose pala tjetër e një instrumenti financiar nuk përmbush detyrimet e tij kontraktuale, dhe ky rrezik buron kryesisht nga huatë dhe paradhëniet e klientëve dhe nga letrat me vlerë të borxhit dhe financimet ndaj institucioneve financiare ose zëra të tjera jashtë bilanci. Për qëllime të raportimit të menaxhimit të rrezikut, Banka konsideron dhe konsolidon të gjitha elementet e ekspozimit të rrezikut të kredisë (si rreziku i mospërmbushjes së detyrimit individual, rreziku sovran ose i industrisë). Banka menaxhon rrezikun e ekspozimit të kredisë sistematikisht duke monitoruar drejtëpërdrejtë limitet e kredive, portofolin e kredive dhe përqëndrimin e ekspozimit.

Menaxhimi i rrezikut të kredisë

Bordi i Drejtorëve ka deleguar përgjegjësitë për administrimin e rrezikut të kredisë tek Komiteti i Kredisë së Bankës. Për mbikëqyrjen e rrezikut të kredisë së Bankës është përgjegjëse Njësia e Rrezikut të Kredisë, e cila raporton tek Drejtori Ekzekutiv.

Menaxhimi i rrezikut të kredisë realizohet përmes:

- Krijimit të politikave të rrezikut të kredisë në konsultim me njësitet e biznesit, duke mbuluar kërkesat për kolateral, vlerësimin e kredive, klasifikimin dhe raportimin e rrezikut, procedurave të shkruara ligjore, dhe pajtueshmëria me kriteret rregullatore dhe ligjore.

- Vendosijes dhe monitorimit të niveleve të delegimit dhe procesit të shkallëzimit në lidhje me miratimet e kredisë. Bordi i Drejtorëve i ka deleguar Komitetit të Kredisë autoritetin për miratimin e shumave deri në ekuivalentin e 3,000,000 EURO për rritjen e limiteve ekzistuese të kredive apo dhënien e kredive të reja, dhe deri në ekuivalentin e 5,000,000 EURO për rinovimin ose ristrukturimin e kredive aktuale. Megjithatë për financimin e sektorëve të veçantë të ekonomisë dhe palëve të tjera të cilat konsiderohen me rrezik të tilla si sektori i pasurive të paluajtshme, ndërtimi, hoteleria, investimet fillestare, institucionet financiare, personat politikë etj., autoriteti për miratimin e kredive i mbetet Bordit të Drejtorëve pavarësisht shumës së financimit.
- Rishikimit dhe vlerësimit të rrezikut të kredisë. Menaxhimi i Bankës dhe Sektori i Vlerësimit të Rrezikut të Kredisë vlerëson të gjithë kufijtë e ekspozimit të kredisë, përpara miratimit përfundimtar nga autoriteti kompetent. Rinovimet dhe rishikimet e huave janë subjekt i po të njëjtit proces.
- Kufizimit të përqëndrimit të ekspozimit ndaj kundërpartive, qofshin përqëndrime gjeografike apo sektoriale të ekonomisë (për kreditë dhe paradhëniet) dhe sipas emetuesit, klasifikimit të kredive, likuiditetit të tregut dhe shtetit (për investimet në letra me vlerë).
- Zhvillimit dhe mirëmbajtjes së sistemit të vlerësimit të

rrezikut të Bankës për të kategorizuar ekspozimin sipas shkallës së rrezikut të humbjes financiare me të cilën përballohet Banka dhe për të fokusuar drejtimin në rreziqet aktuale të Bankës. Klasifikimi i rrezikut përdoret për të përcaktuar se kur mund të kërkohej zhvlerësim kundrejt ekspozimeve specifike të kredisë.

Kuadri aktual i klasifikimit të rrezikut konsiston në pesë kategori: a) standarde, b) në ndjekje, c) nën-standarde, d) e dyshimtë dhe e) e humbur. Kreditë e klasifikuara në dy kategoritë e para konsiderohen si kredi pa probleme. Kreditë e tre kategorive të tjera konsiderohen si kredi me probleme. Përveç kriterit të ditëvonesave, Banka gjithashtu përdor kriteret cilësore të mëposhtme për përcaktimin e kategorizimit të rrezikut të kredive:

- Aftësia paguese
- Kushtet financiare
- Aftësitë menaxhuese
- Kolateralin dhe garantët
- Struktura e kredive

Kreditë me kushte të rinegociueshme janë kredi që janë ristrukturuar për shkak të përkeqësimit të situatës financiare të huamarrësit dhe për të cilat Banka ka bërë lëshime që përndryshe nuk do të konsideronte. Kreditë me kushte të rinegociueshme janë konsideruar si të zhvlerësuara individualisht në vitin e parë që nga implementimi i ristrukturimit.

Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë	Ekspozimi Maksimal Bruto	
	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Mjete monetare dhe të ngjashme (me përjashtim të mjeteve monetare në arkë)	3,176,444	4,087,929
Hua dhe paradhënie bankave	3,126,071	4,367,509
Letra me vlerë të vendosjes	10,970,639	5,634,132
Letra me vlerë të investimit	6,888,858	-
Hua dhe paradhënie klientëve	9,289,448	8,799,326
Debitorë të tjerë	28,643	28,389
Totali i ekspozimit të rrezikut të kredisë për zërat e bilancit	33,480,103	22,917,285
Angazhime të patërheqshme ndaj klientëve	429,535	508,549
Garanci në favor të klientëve	1,497,848	510,954
Totali i angazhimeve të lidhura me kredinë	1,927,383	1,019,503
Totali i rrezikut të kredisë	35,407,486	23,936,788

Nëse aktivet financiare regjistrohen me vlerën e drejtë, shumat e paraqitura përfaqësojnë ekspozimin aktual të rrezikut të kredisë, por jo ekspozimin maksimal që mund të lindë në të ardhmen si rezultat i ndryshimeve në vlera. Banka vë në dispozicion të klientëve të saj garanci të cilat mund kërkojnë që Banka të bëjë pagesa në favor të tyre dhe të marr angazhime për të zgjeruar linjat e kredisë për t'ju siguruar likuiditetin e nevojshëm. Angazhime të tilla e ekspozojnë Bankën ndaj rreziqeve të ngjashme të kredisë, të cilat zbuten me të njëjtat politika dhe procese kontrolli. Çdo muaj Banka vlerëson angazhimet e lidhura me kredinë për zhvlerësim. Shumat subjekt i vlerësimeve individuale për zhvlerësim janë angazhime të pa-

anullueshme dhënë klientëve të këqinj ose klientëve me kredi të ristrukturuara.

Cilësia e kredisë sipas kategorive të aktiveve financiare

Tabelat e mëposhtme paraqesin cilësinë e kredisë së aktiveve financiare të ekspozuara ndaj rrezikut të kredisë, bazuar në klasifikimin e brendshëm të bankës. Portofoli i kredive pa probleme konsiderohet si jo në vonesë dhe jo i zhvlerësuar individualisht. Aktivet financiare në tabelat më poshtë janë të paraqitura bruto pa zbritur zhvlerësimet për vitet e mbyllura më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015.

31 Dhjetor 2016	Jo në vonesë dhe jo të zhvlerësuara individualisht	Në vonesë, por jo të zhvlerësuara individualisht	Të zhvlerësuara individualisht	Totali
Mjete monetare dhe të ngjashme (pa përfshirë paranë në arkë)	3,176,444	-	-	3,176,444
Hua dhe paradhënie bankave	3,126,071	-	-	3,126,071
Hua tregtare	5,929,115	92,578	975,740	6,997,433
Hua hipotekore	2,641,041	155,417	270,170	3,066,628
Hua konsumatore	271,668	2,662	9,968	284,298
Hua dhe paradhënie klientëve:	8,841,824	250,657	1,255,878	10,348,359
	15,144,339	250,657	1,255,878	16,650,874
Investimet në letra me vlerë:				
Qeveria Shqiptare	17,859,497	-	-	17,859,497
	17,859,497	-	-	17,859,497
Totali	33,003,836	250,657	1,255,878	34,510,371

31 Dhjetor 2015	Jo në vonesë dhe jo të zhvlerësuara individualisht	Në vonesë, por jo të zhvlerësuara individualisht	Të zhvlerësuara individualisht	Totali
Mjete monetare dhe të ngjashme (pa përfshirë paranë në arkë)	4,087,929	-	-	4,087,929
Hua dhe paradhënie bankave	4,367,509	-	-	4,367,509
Hua tregtare	4,657,594	266,667	1,756,093	6,680,354
Hua hipotekore	2,643,046	24,564	479,031	3,146,641
Hua konsumatore	97,639	22,249	10,845	130,733
Hua dhe paradhënie klientëve:	7,398,279	313,480	2,245,969	9,957,728
	15,853,717	313,480	2,245,969	18,413,166
Investimet në letra me vlerë:				
Qeveria Shqiptare	5,634,132	-	-	5,634,132
	5,634,132	-	-	5,634,132
Totali	21,487,849	313,480	2,245,969	24,047,298

Sikurse më 31 dhjetor 2016, kreditë e zhvlerësuara individualisht kanë rënë kryesisht për shkak të shlyerjeve dhe fshirjeve të kredive të bëra gjatë vitit 2016.

Cilësia e Kredisë sipas kategorive të aktiveve financiare

Një analizë vjetërsie e kredive jo në vonesë dhe jo të zhvlerësuara individualisht më 31 Dhjetor 2016 dhe 2015 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

31 Dhjetor 2016	Më pak se 30 ditë	31 në 60 ditë	61 në 90 ditë	Totali
Hua dhe paradhënie klientëve:				
Hua tregtare	5,725,812	190,907	12,396	5,929,115
Hua hipotekore	2,443,518	146,072	51,451	2,641,041
Hua konsumatore	269,789	1,223	656	271,668
Totali	8,439,119	338,202	64,503	8,841,824

31 Dhjetor 2015	Më pak se 30 ditë	31 në 60 ditë	61 në 90 ditë	Totali
Hua dhe paradhënie klientëve:				
Hua tregtare	4,432,428	196,915	28,251	4,657,594
Hua hipotekore	2,495,525	92,560	54,961	2,643,046
Hua konsumatore	92,791	4,150	698	97,639
Totali	7,020,744	293,625	83,910	7,398,279

Një analizë vjetërsie e kredive në vonesë por jo të zhvlerësuara më 31 Dhjetor 2016 dhe 2015 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

31 Dhjetor 2016	91 në 180 ditë	më shumë se 180 ditë	Totali
Hua dhe paradhënie klientëve:			
Hua tregtare	85,288	7,290	92,578
Hua hipotekore	101,029	54,388	155,417
Hua konsumatore	867	1,795	2,662
Totali	187,184	63,473	250,657

31 Dhjetor 2015	91 në 180 ditë	më shumë se 180 ditë	Totali
Hua dhe paradhënie klientëve:			
Hua tregtare	264,759	1,908	266,667
Hua hipotekore	10,114	14,450	24,564
Hua konsumatore	17,619	4,630	22,249
Totali	292,492	20,988	313,480

Huatë dhe letrat me vlerë të zhvlerësuar

Huatë e zhvlerësuar janë ato për të cilat Banka vlerëson se mund të mos jetë në gjëndje të mbledhë principalin dhe interesin e arkëtueshëm sipas kushteve kontraktuale të marrëveshjes(ve). Banka i klasifikon huadhëniet dhe paradhëniet ndaj klientëve në kategori pa probleme dhe me probleme siç përshkruhet më lart dhe kryen teste të zhvlerësimit për të gjitha huatë që shfaqin evidenca objektive për zhvlerësim, duke vlerësuar fluksin e skontuar monetar të ardhshëm dhe duke e krahasuar me vlerën kontabël të mbetur respektive të huasë. Huatë, të cilat nuk paraqesin evidenca për t'u zhvlerësuar individualisht, vlerësohen për zhvlerësim në grup. Zhvlerësimi në grup aplikohet gjithashtu edhe për klientë të testuar individualisht por që kanë rezultuar të mos kenë nevojë për zhvlerësim individual.

Fondi për humbjet nga zhvlerësimi

Banka krijon një fond për humbjet nga zhvlerësimi i kredive që përfaqëson një përlllogaritje për humbjet e realizuara në portofolin e kredive. Komponentët kryesorë të këtij fondi përfshijnë komponentin e humbjes specifike që lidhet me ekspozime individualisht të rëndësishme si dhe me ekspozime më pak të rëndësishme dhe të vlerësuar në grup dhe me një fond humbjes nga kreditë në grup i krijuar për grupe homogjene aktivesh,

në lidhje me humbjet që janë pësuar, por akoma nuk janë të identifikuar në kreditë që janë subjekt i vlerësimeve për zhvlerësim individual.

Kreditë me kushte të rinegociueshme

Kushtet kontraktuale të një kredie mund të modifikohen për një sërë arsyesh, duke përfshirë ndryshimet në kushtet e tregut, ruajtjen e mardhënies me klientin dhe faktorë të tjerë jo të lidhura me një përkeqësim aktual ose potencial të situatës së kreditorit. Një kredi ekzistuese termat e së cilës janë modifikuar mund të çregjistrohet dhe kredia e rinegociuar mund të njihet si një kredi e re me vlerë të drejtë. Banka rinegocion kreditë e klientëve në vështirësi financiare (të referuara si "aktivitete në ristrukturim") për të maksimizuar mundësitë e grumbullimit dhe të minimizojnë rrezikun e mospagimit.

Pavarësisht nëse kreditë me kushte të rinegociueshme janë çregjistruar, ato vazhdojnë të paraqiten si të zhvlerësuar deri sa provohet se rreziku i mospagimit së flukseve monetare të ardhshme është reduktuar ndjeshëm dhe nuk ka tregues të tjerë për zhvlerësim.

Cilësia e Kredisë sipas kategorive të aktiveve financiare

Tabela më poshtë tregon huatë dhe paradhëniet neto ndaj klientëve të klasifikuar në dy grupe kryesore: Të zhvlerësuar individualisht dhe në grup.

	Ekspozimi Neto i huave dhe paradhënieve ndaj klientëve	
	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Individualisht të zhvlerësuar		
Balanca bruto	1,255,878	2,245,969
Zbritja për humbjet nga zhvlerësimi	(792,266)	(899,751)
Vlera kontabël	463,612	1,346,218
Të zhvlerësuar në grup		
Balanca bruto	9,092,481	7,711,759
Zbritja për humbjet nga zhvlerësimi	(266,645)	(258,651)
Vlera kontabël	8,825,836	7,453,108
Total i vlerës kontabël të Huave dhe paradhënieve për klientët	9,289,448	8,799,326

Lëvizjet e veçanta për zhvlerësimet individuale dhe në grup paraqiten të detajuara në shënimin 10.

Më poshtë paraqitet një analizë e balancave bruto dhe neto (të zbritjeve për zhvlerësime) për huatë e zhvlerësuara individualisht sipas klasifikimit të rrezikut:

	Hua dhe paradhënie klientëve individualisht të zhvlerësuara	
	Bruto	Neto
31 Dhjetor 2016		
Hua të dyshimta	683,029	191,150
Hua të humbura	572,849	272,462
Totali	1,255,878	463,612
31 Dhjetor 2015		
Hua të dyshimta	981,092	664,665
Hua të humbura	1,264,877	681,553
Totali	2,245,969	1,346,218

Më poshtë paraqitet vlera kontabël e huave dhe paradhënies të ristrukturuara ndaj klientëve, neto nga zbritja për zhvlerësim, sipas produkteve:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Hua tregtare	1,136,928	1,131,999
Hua hipotekore	216,033	115,229
Hua konsumatore	74	139
Totali	1,353,035	1,247,367

Politikat e fshirjes nga librat kontabël

Banka fshin nga librat e saj një gjëndje huaje/letra me vlerë (dhe zbritjet për zhvlerësime nga humbje të lidhura me të) kur Komiteti i Çështjeve Sensitive dhe Provigjonimit (SAC) përcakton se huaja/letra me vlerë është e pa arkëtueshme. Ky vendim arrihet pas marrjes në konsideratë të informacioneve për ndryshime të rëndësishme në pozicionin financiar të huamarrësit/emetuesit, të tilla që huamarrësi/emetuesi nuk mund të paguajë më detyrimet, dhe përfitimet nga kolateralet nuk do të jenë të mjaftueshme për të mbuluar të gjithë ekspozimin. Për kreditë e standartizuara me vlerë më të vogël, vendimet për fshirjen, bazohen në statusin specifik të vonesave në pagesa të produktit si edhe në veprimet ligjore të ndjekura lidhur me procedurën e zbatimit.

Banka zotëron kolateral kundrejt kredive dhe paradhënies ndaj klientëve. Banka zbaton udhëzimet e saj të brendshme mbi pranueshmërinë e klasave specifike të kolateraleve ose të teknikave të zbutjes së rrezikut të

kredisë. Banka zotëron kolaterale kryesisht në formën e:

- Hipotekave të pasurive të paluajtshme rezidenciale ose të biznesit;
- Pengjeve mbi aktivet e biznesit në funksionim, të tilla si makineri dhe pajisje, inventare dhe llogari të arkëtueshme;
- Mjete monetare të lëna garanci dhe letra me vlerë (si Bono Thesari), etj.

Vlerësimet e vlerës së drejtë bazohen në vlerën e kolateralit të vlerësuar në kohën e huamarjes dhe përgjithësisht përditësohen mbi baza vjetore.

Flukset e parashikuara të të ardhurave nga kolateralet përfshirë garancitë që mbulojnë ekspozimet janë zakonisht burimi kryesor i flukseve të ardhshme të mjeteve monetare nga kreditë me probleme. Disa nga parametrat e vlerësimit të përdorura për llogaritje janë:

- Vlera e realizueshme e kolateraleve, e cila përllogaritet duke ulur vlerën e tregut të kolateraleve me një 'faktor skontimi'. Kjo merr në konsideratë karakteristikat e

grupeve të ngjashme të kolateraleve dhe supozon një vlerë mesatare të rikupërueshme të një kolaterali të caktuar, bazuar në eksperiencën e Bankës.

- Koha e flukseve të parashikuara/pritura të parasë, e cila i referohet kohës së pritshme të rikupërimit (në vite) të një lloji të caktuar kolaterali.

Kolaterali përgjithësisht nuk mbahet për huatë dhe paradhëniet ndaj institucioneve financiare, përveç kur instrumentet financiare mbahen si pjesë e marrëveshjeve të riblerjeve dhe aktivitetit të huamarrjes të letrave me vlerë.

Për qëllimin e llogaritjes së zhvlerësimit individual të kredive dhe paradhënieve ndaj klientëve, kolaterale të

janë marrë në konsideratë për llogaritjen e zhvlerësimit janë vetëm pasuritë e paluajtshme, mjetet monetare të vendosura si kolateral dhe garancitë bankare.

Nuk ka kolaterale mbi huatë dhe paradhëniet ndaj bankave përveç rasteve të marrëveshjeve të riblerjes të anasjelltja. Për pjesën me të madhe të portofolit të kredisë vlera e drejtë e kolateralit tejkalon shumën e kredive, megjithatë, Banka normalisht e skonton vlerën e drejtë të kolateralit me të paktën 44% (2015: 40%) në mënyrë që të mbajë parasysh vështirësitë praktike dhe administrative të ekzekutimit të një kolaterali. Në këtë mënyrë Banka mbrohet nga mospagesat e mundshme nga klienti.

Një përlogaritje e vlerës së drejtë të paskontuar dhe të skontuar të kolateraleve dhe garancive të tjera, të mbajtura kundrejt aktiveve financiare tregohet më poshtë:

	Kolaterale për Huatë dhe paradhëniet ndaj klientëve		Kolaterale për Huatë dhe paradhëniet ndaj klientëve	
	31 Dhjetor 2016		31 Dhjetor 2015	
	Paskontuar	Skontuar	Paskontuar	Skontuar
Ndaj të zhvlerësuarave Individualisht				
Ndërtesa	2,019,536	1,107,095	4,652,342	2,031,579
Pengje dhe garanci	-	-	9,457	9,457
Totali	2,019,536	1,107,095	4,661,799	2,041,036
Vlera kontabël neto		463,612		1,346,218
Ndaj të zhvlerësuarave në grup				
Ndërtesa	25,198,069	13,737,273	22,163,262	9,662,215
Mjete monetare	880,229	880,229	270,537	270,537
Totali	26,078,298	14,617,502	22,433,799	9,932,752
Vlera kontabël neto:		8,825,836		7,453,108

Në rastin e kolateraleve të marra në pronësi, qëllimi kryesor i Bankës është konvertimi i tyre në mjete monetare, nëpërmjet fushatave promovionale për shitjen e tyre. Të ardhurat e mbledhura përdoren për zvogëlimin ose likuidimin e vlerës së mbetur të kredive. Nëse nuk ka asnjë ofertë të kënaqshme, praktika e Bankës është të mbajë aktivin në inventarët e saj për shitje deri sa

të marrë ofertën më të mirë. Në varësi të nevojave operacionale të Bankës dhe përshtatshmërisë së aktivitetit për t'i plotësuar ato nevoja, menaxhimi vendos ta verë në përdorim pasurinë, në të tilla raste kryhet një riklasifikim në aktivet materiale në kategorinë afatgjatë. Natyra dhe vlerat përkatëse të aktiveve të marra në zotërim janë paraqitur në shënimin 13.

Banka monitoron përqendrimit e rrezikut të kredisë sipas sektorëve dhe vendit. Analiza e rrezikut të kredisë në datën e raportimit paraqitet si më poshtë:

Hua dhe paradhënie ndaj klientëve, neto		
Përqendrimi sipas sektorëve	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Shërbimet	1,169,055	1,677,674
Shitja me shumicë	2,790,618	2,599,259
Ndërtimi	269,490	275,384
Prodhimi	989,237	737,797
Pasuritë e patundshme	472,522	74,740
Të tjera	554,985	465,311
Biznese	6,245,907	5,830,165
Kredi hipotekore	2,823,729	2,872,239
Kredi konsumatore	219,812	96,922
Individë	3,043,541	2,969,161
Vlera kontabël	9,289,448	8,799,326

Hua dhe paradhënie bankave		
Përqendrimi sipas sektorëve	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Banka	3,126,071	4,367,509
Vlera kontabël	3,126,071	4,367,509

Letra me vlerë		
Përqendrimi sipas sektorëve	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Letra me vlerë të Qeverisë Shqiptare	17,859,497	5,634,132
Vlera kontabël	17,859,497	5,634,132

Cilësia e kredisë të ekspozimit maksimal të kredisë së letrave me vlerë të borxhit bazuar në klasifikimin Moody, kur është e zbatueshme, vijon si më poshtë:

Investime Financiare letrat me vlerë të borxhit		
Qeveria Shqiptare	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Klasifikimi B1	17,859,497	5,634,132
	17,859,497	5,634,132

Përqëndrimi i Rrezikut të Kredisë

Portofoli i rrezikut të kredisë të Bankës karakterizohet nga përqëndrimet e mëposhtme të rrezikut të kredisë.

	31 Dhjetor 2016	Ekspozimi Në %	31 Dhjetor 2015	Ekspozimi Në %
Letrat me vlerë të Republikës së Shqipërisë	17,859,497	53%	5,634,132	25%
Gjëndjet me Bankën e Shqipërisë	5,721,156	17%	6,160,515	27%
Reziku total me Qeverinë Shqiptare	23,580,653	70%	11,794,647	52%
Ekspozimi më i madh me Bankat	556,028	2%	1,110,055	5%
Ekspozimi më i madh me klientët	467,216	1%	476,246	2%
Totali i ekspozimeve të mëdha me bankat dhe klientët	1,023,244	3%	1,586,301	7%
Totali i rrezikut për zërat e bilancit	24,603,897	73%	13,380,948	59%

Pala tjetër për ekspozimin më të madh me bankat më 31 Dhjetor 2016 është me një Bankë të huaj, Banka Credit Agricole (2015: Bankë vendase, Banka Kombetare Tregtare). Pala tjetër për ekspozimin më të madh me klientët në 31 Dhjetor 2016 është Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (2015: Korporata Elektroenergjitike Shqiptare).

Rreziku i shlyerjes

Aktivitetet e Bankës mund të shkaktojnë rrezik në momentin e shlyerjes së transaksioneve dhe tregtimeve. Rreziku i shlyerjes është rreziku i humbjeve për shkak të dështimit të një shoqërie në përmbushjen e detyrimeve të saj për të dhënë mjete monetare, letra me vlerë ose aktive të tjera ashtu siç është rënë dakort në kontratë. Rreziku i shlyerjes me institucione financiare dhe kundërpartinë tjetër qeveritare përfshihet brenda një sistemi limitesh për të gjitha transaksionet me këto kundërparti dhe është objekt i monitorimit të përditshëm, përcaktuar dhe rregulluar sipas rregullores së Bankës Qendrore të Shqipërisë "Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankës"

(b) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është përcaktuar si paaftësia e mundshme e një institucioni për të përmbushur detyrimet që ka për shkak të pamjaftueshmërisë së likuiditetit ose pamundësisë për të siguruar financim të mjaftueshëm nga tregu (rreziku i likuiditetit nga financimi), ose për shkak të vështirësive që lidhen me konvertimin e pozicionit në aktive financiare pa ndikuar negativisht dhe në mënyrë të rëndësishme çmimet, për shkak të kushteve të papërshtatshme ose çrregullimeve të përkohshme të tregut.

Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit

Përqasja e Bankës për të administruar likuiditetin është të sigurojë, sa më gjatë të jetë e mundur, të ketë gjithnjë

likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet e saj në kohë, si në kushte normale dhe në kushte të vështira, pa pësuar humbje të papranueshme apo dëmtuar reputacionin e saj.

Menaxhimi i procesit të likuiditetit të Bankës përfshin:

- Financimin e përditshëm, të menaxhuar nga monitorimi i flukseve të ardhshme të mjeteve monetare për të siguruar përmbushjen e kërkesave. Kjo përfshin rivendosjen e fondeve në kohën që maturohen ose merren hua nga klientët;
- Mbajtjen e një portofoli aktivesh likuide dhe të tregtueshme;
- Monitorimin e raporteve të likuiditetit të bilancit ndaj kërkesave të brendshme dhe rregullatore;
- Menaxhimin e përqendrimet dhe profilizimin e borxheve të maturuara.

Përgjegjësia për administrimin e situatës së përditshme të likuiditetit mbetet nën monitorimin e Sektorit të Thesarit. Raportet e përditshme dhe shkëmbimi i informacioneve ndërmjet funksioneve të ndryshme të Bankës mbulojnë flukset monetare të vlerësuar për ditën, javën, dhe muajin pasues që konsiderohen si periudha kyçe të menaxhimit të likuiditetit. Pikënisja e projekteve është analiza e maturitetit kontraktual të detyrimeve financiare dhe data e pritshme e mbledhjes për aktivet financiare. Menaxhimi i likuiditetit për periudhat afatshkurtëra dhe afatmesme është në përgjegjësinë e ALCO-s. ALCO analizon në baza mujore situatën e likuiditetit të Bankës dhe propozon veprimet që konsiderohen si të nevojshme.

Elementi kyç i përdorur nga Banka për administrimin e rrezikut të likuiditetit është raporti i aktiveve likuide mbi detyrimet afatshkurtra dhe hendeuku kumulativ deri në 3 muaj. Për këtë qëllim aktivet likuide konsiderohen mjetet monetare dhe ekuivalentët me to si dhe portofoli i letrave me vlerë të vlefshme për shitje. Raportet e likuiditetit të përcaktuara nga Banka janë në përputhje me kërkesat e Bankës së Shqipërisë të vendosura nga Rregullorja "Mbi

administrimin e rrezikut të likuiditetit".

Banka përllorarit mbi baza ditore dhe mujore raportet e mëposhtme: aktivet likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra, huatë ndaj depozitave dhe aktivet likuide ndaj depozitave.

Aktivët likuide konsiderohen mjetet monetare dhe ekuivalentët me to, bonot e thesarit të qeverisë Shqiptare dhe çdo depozitë afatshkurtër me bankat të cilat matorohen brenda 7 ditëve.

Detaje të raportit të aktiveve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra gjatë periudhës raportuese ka qenë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Mesatarja për periudhën	58.10%	44.64%
Minimumi për periudhën	44.26%	33.30%
Maksimumi për periudhën	70.48%	55.79%

Tabela në vijim tregon gjëndjen e likuiditetit të Bankës monitoruar aktualisht nga drejtimi i Bankës më 31 Dhjetor 2016. Janë marrë në konsideratë flukset monetare të paskontuara hyrëse/dalëse të Bankës për aktivet dhe detyrimet financiare të bilancit dhe jashtë bilancit, sipas

maturiteteve kontraktuale dhe duke mos reflektuar ndonjë ripagesa të hershme apo supozime për historikun e mbajtjes. Nëse maturimi kontraktual nuk është i aplikueshëm, Banka ka përdorur gjykimin në vlerësimin e periudhës kur këto instrumenta do të matorohen.

31 Dhjetor 2016	1 muaj	1-3 muaj	3-12 muaj	1-5 vite	mbi 5 vite	Totali
Aktivët (Flukse monetare hyrëse)						
Mjetet monetare, neto	4,017,943	-	-	-	-	4,017,943
Rezerva e detyrueshme	2,544,712	-	-	-	-	2,544,712
Paradhënie bankave	581,359	-	-	-	-	581,359
Investime në letra me vlerë	140,754	72,077	1,783,942	11,248,282	9,191,084	22,436,139
Hua dhe paradhënie klientëve (hua bruto pa probleme)	507,863	563,023	3,154,334	3,109,117	1,619,198	8,953,535
Aktive financiare të tjera	2,905	-	443	4,343	-	7,691
Totali	7,795,536	635,100	4,938,719	14,361,742	10,810,282	38,541,379
Detyrime (Flukse monetare dalëse)						
Llogari rrjedhëse me bankat	-	-	-	-	-	-
Llogari rrjedhëse me klientët	8,629,218	-	-	-	-	8,629,218
Depozita nga bankat	926,737	-	-	-	-	926,737
Depozita me afat nga klientët	3,025,615	3,151,878	10,972,442	5,349,472	718,852	23,218,259
Borxhi i varur	5,017	781	23,224	117,377	1,438,153	1,584,552
Detyrime të tjera financiare	162,152	31,655	17	7,255	-	201,079
Totali	12,748,739	3,184,314	10,995,683	5,474,104	2,157,005	34,559,845
Hendeku total i zërave të bilancit	(4,953,203)	(2,549,214)	(6,056,964)	8,887,638	8,653,277	3,981,534
Zëra jashtë bilancit (Flukse monetare hyrëse)	-	-	-	-	-	-
Zëra jashtë bilancit (Flukse monetare dalëse)	8,606	10,918	307,210	83,166	19,634	429,534
Hendeku total i zërave jashtë bilancit	(8,606)	(10,918)	(307,210)	(83,166)	(19,634)	(429,534)
Hendeku total 31 Dhjetor 2016	(4,961,809)	(2,560,132)	(6,364,174)	8,804,472	8,633,643	3,552,000
Hendeku i akumuluar 31 Dhjetor 2016	(4,961,809)	(7,521,941)	(13,886,115)	(5,081,643)	3,552,000	-

Si pjesë e administrimit të rrezikut të likuiditetit që rrjedh nga detyrimet financiare, Banka mban aktive likuide që përfshijnë mjete monetare dhe të ngjashme me to dhe letra me vlerë të borxhit të emetuara nga qeveria, të cilat mund të shiten lehtësisht për të përmbushur

nevojat për likuiditet. Flukset monetare të pritshme te Bankës për disa detyrime financiare variojnë në mënyrë të konsiderueshme nga flukset monetare kontraktuale si për shembull llogaritë rrjedhëse të klientëve të cilat priten të jenë të qëndrueshme dhe nuk priten të tërhiqen.

31 Dhjetor 2015	Deri në 1 muaj	1-3 muaj	3-12 muaj	1-5 vite	mbi 5 vite	Totali
Aktivët (Flukse monetare hyrëse)						
Mjetet monetare, neto	4,910,984	-	-	-	-	4,910,984
Rezerva e deturueshme	2,072,586	-	-	-	-	2,072,586
Paradhënie bankave	2,295,227	-	-	-	-	2,295,227
Investime në letra me vlerë	135,648	60,673	650,145	3,734,024	3,707,748	8,288,238
Hua dhe paradhënie klientëve (hua bruto pa probleme)	437,660	758,988	3,256,016	2,554,606	1,477,944	8,485,214
Aktive financiare të tjera	641	-	-	4,211	-	4,852
Totali	9,852,746	819,661	3,906,161	6,292,841	5,185,692	26,057,101
Detyrime (Flukse monetare dalëse)						
Llogari rrjedhëse me bankat	9	-	-	-	-	9
Llogari rrjedhëse me klientët	5,478,043	-	-	-	-	5,478,043
Depozita nga bankat	172,493	-	-	-	-	172,493
Depozita me afat nga klientë	2,065,684	3,153,475	10,592,925	1,929,186	-	17,741,270
Borxhi i varur	15,405	8,586	39,353	955,729	344,694	1,363,767
Detyrime të tjera financiare	93,904	167	154	-	-	94,225
Totali	7,825,538	3,162,228	10,632,432	2,884,915	344,694	24,849,807
Hendeku total i zërave të bilancit	2,027,208	(2,342,567)	(6,726,271)	3,407,926	4,840,998	1,207,294
Zëra jashtë bilanci (Flukse monetare hyrëse)	-	-	-	-	-	-
Zëra jashtë bilanci (Flukse monetare dalëse)	33,243	105,530	251,100	100,102	18,574	508,549
Hendeku total i zërave jashtë bilancit	(33,243)	(105,530)	(251,100)	(100,102)	(18,574)	(508,549)
Hendeku total 31 Dhjetor 2015	1,993,965	(2,448,097)	(6,977,371)	3,307,824	4,822,424	698,745
Hendeku i akumuluar 31 Dhjetor 2015	1,993,965	(454,132)	(7,431,503)	(4,123,679)	698,745	-

Informacioni më poshtë lidhet me fluksin e mjeteve monetare që vjen nga detyrimet financiare jashtë bilancit, kështu që ndryshon në mënyrë të konsiderueshme nga prezantimi në pasqyrën e pozicionit financiar. Analiza nuk përfshin detyrimet jo-financiare dhe kapitalin dhe përfshin flukset e mjeteve monetare nga interesi kontraktual.

Tabela më poshtë tregon detyrimet e kushtëzuara dhe angazhimet financiare të Bankës:

31 Dhjetor 2016	1 Muaj	1-3 Muaj	3-12 Muaj	1-5 Vite	> 5 Vite	Totali
Angazhime	8,606	10,918	307,210	83,167	19,634	429,535
Garanci	10,000	692,624	720,885	74,339	-	1,497,848
31 Dhjetor 2015						
Angazhime	33,243	105,530	251,100	100,102	18,574	508,549
Garanci	212,197	97,167	98,191	103,399	-	510,954

Banka pret që vetëm një pjesë e vogël e angazhimeve të kërkohet brenda një muaji dhe garancitë të mbyllen sipas afatit të maturimit. Shikoni gjithashtu shënimin 30 mbi angazhimet dhe detyrimet e kushtëzuara.

Rakordimi ndërmjet tabelës së maturitetit të angazhimeve dhe detyrimeve të kushtëzuara dhe shënimin 30 - Angazhimet dhe Detyrimet e Kushtëzuara është si më poshtë:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Angazhime		
Hua të aprovuara të pa disbursuara	429,535	508,549
Garanci	1,497,848	510,954
Letër Kredi	574,059	54,912
Garanci në favor të klientëve	923,789	456,042

Flukset monetare të paskontuara për detyrimet financiare të bilancit më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015 vijojnë si më poshtë:

31 Dhjetor 2016	Vlera kontabël	Fluksi Monetar bruto	1 Muaj	1-3 Muaj	3-12 Muaj	1-5 Vite	>5 Vite
Detyrime ndaj bankave	926,609	926,737	-	-	-	-	926,737
Detyrime ndaj klientëve	31,459,195	31,847,477	11,654,833	3,151,878	10,972,442	5,349,472	718,852
Borxhi i varur	1,091,909	1,584,552	5,017	781	23,224	117,377	1,438,153
31 Dhjetor 2015							
Detyrime ndaj bankave	172,940	172,493	172,493	-	-	-	-
Detyrime ndaj klientëve	22,848,075	23,219,313	7,543,727	3,153,475	10,592,925	1,929,186	-
Borxhi i varur	1,113,597	1,363,767	15,405	8,586	39,353	955,729	344,694

(c) Rreziku i Tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimet në çmimet e tregut, si norma e interesit, çmimet e kapitalit, kurset e këmbimit të monedhave të huaja, nivelet e kredisë (jo të lidhura me ndryshime të gjëndjes së debitorit/emetuesit) do të ndikojnë fitimet e Bankës ose vlerën e instrumenteve financiare. Objektivi i menaxhimit të rrezikut të tregut është të menaxhojë dhe kontrollojë ekspozimet ndaj rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, duke optimizuar kthimin mbi rrezikun.

Menaxhimi i Rreziqeve të Tregut

Banka mban portofolin e saj të letrave me vlerë në përputhje me SNF 39 si të vlefshme për shitje ose të mbajtura deri në maturim.

Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit

Rreziku i kursit të këmbimit përkufizohet si mundësia që luhatjet e kurseve të këmbimit të krijojnë ndryshime të konsiderueshme, pozitive ose negative në pasqyrën e pozicionit financiar të Bankës. Burimet më të rëndësishme të rrezikut të normës së këmbimit konsistojnë në:

- Huadhëniet në monedhë të huaj dhe depozitat në monedhë të huaj të korporatave dhe individëve;
- Investime në letrat me vlerë;
- Tregtimi i kartëmonedhave të huaja;
- Arkëtimi ose pagesa e interesit, komisioneve, kostove administrative, etj. në monedha të huaja.

Bordi i Drejtorëve vendos kufij mbi nivelin e ekspozimit për të dy pozicionet, njëditore dhe brenda ditës të cilat monitorohen çdo ditë nga specialisti i Rrezikut Operacional dhe Kontrollit të Vazhdueshëm.

Analiza e mëposhtme përfshin vetëm aktivet dhe detyrimet monetare të shprehura në LEK dhe monedha të huaja. Tabela e mëposhtme përmlendh ekspozimin e Bankës ndaj rrezikut të kursit të këmbimit në datën e bilancit. Ekspozimi i Bankës ndaj rrezikut të kursit të këmbimit më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015 është si më poshtë:

31 Dhjetor 2016	ALL	EUR	USD	Të tjera	Totali
Aktive					
Mjete monetare dhe të ngjashme	903,992	2,741,188	372,763	-	4,017,943
Hua dhe paradhënie ndaj bankave	1,348,201	1,688,901	83,127	5,842	3,126,071
Letra me vlerë të vendosjes	9,629,602	1,341,037	-	-	10,970,639
Letra me vlerë të investimit	6,888,858	-	-	-	6,888,858
Hua dhe paradhënie ndaj klientëve	1,104,524	7,881,418	303,505	1	9,289,448
Aktive të tjera financiare	2,025	4,765	899	1	7,690
Totali	19,877,202	13,657,309	760,294	5,844	34,300,649
Detyrime					
Detyrime ndaj bankave	926,609	-	-	-	926,609
Detyrime ndaj klientëve	17,979,810	12,706,000	769,198	4,187	31,459,195
Borxhi i varur	-	1,091,909	-	-	1,091,909
Detyrime të tjera financiare	39,679	161,400	-	-	201,079
Totali	18,946,098	13,959,309	769,198	4,187	33,678,792
Pozicioni neto	931,104	(302,000)	(8,904)	1,657	621,857

31 Dhjetor 2015	ALL	EUR	USD	Të tjera	Total
Aktive					
Mjete monetare dhe të ngjashme	781,852	3,968,275	160,857	-	4,910,984
Hua dhe paradhënie ndaj bankave	2,497,176	1,392,177	440,275	37,881	4,367,509
Letra me vlerë të vendosjes	4,370,380	1,263,752	-	-	5,634,132
Hua dhe paradhënie ndaj klientëve	809,472	7,342,647	647,207	-	8,799,326
Aktive të tjera financiare	1,736	2,236	881	-	4,853
Totali	8,460,616	13,969,087	1,249,220	37,881	23,716,804
Detyrime					
Detyrime ndaj bankave	172,940	-	-	-	172,940
Detyrime ndaj klientëve	11,701,600	9,927,986	1,180,104	38,385	22,848,075
Borxhi i varur	-	1,113,597	-	-	1,113,597
Detyrime të tjera financiare	41,521	48,265	625	3,813	94,224
Totali	11,916,061	11,089,848	1,180,729	42,198	24,228,836
Pozicioni neto	(3,455,445)	2,879,239	68,491	(4,317)	(512,032)

Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit

Rreziku kryesor i normës së interesit ndaj të cilit janë të ekspozuar portofolet e Bankës është rreziku i humbjes nga luhatjet e flukseve të ardhshme të mjeteve ose vlerave të drejta të instrumenteve financiare për shkak të një ndryshimi në normat e interesave të tregut. Rreziku krijohet fillimisht nga portofoli i letrave me vlerë, si edhe aktiviteti bankar i lidhur me korporatat dhe individët. Rreziku i normave të interesit menaxhohet kryesisht

nëpërmjet monitorimit periodik të shpërndarjes të normave të interesit midis aktiveve dhe detyrimeve të Bankës si dhe duke përgatitur skenarë analizash mbi normat e interesit për qëllime vendimarrjeje.

Skenarët standardë që konsiderohen mbi baza mujore përfshijnë një rënie ose ngritje prej 300 pikësh bazë (bps) në të gjitha normat e interesit deri në një vit dhe një rënie ose ngritje prej 200 pikësh bazë (bps) në të gjitha normat e interesit për më shumë se një vit.

	31 Dhjetor 2015			
	Skenari Deri në 1 Vit		Skenari Mbi 1 Vit	
	300 pikë bazë Ngritje	300 pikë bazë Ulje	200 pikë bazë Ngritje	200 pikë bazë Ulje
Efekti i vlerësuar në Fitim/ (Humbje)	(123,754)	123,754	64,913	(64,913)

	31 Dhjetor 2015			
	Skenari Deri në 1 Vit		Skenari Mbi 1 Vit	
	300 pikë bazë Ngritje	300 pikë bazë Ulje	200 pikë bazë Ngritje	200 pikë bazë Ulje
Efekti i vlerësuar në Fitim/ (Humbje)	(135,123)	135,123	84,168	(84,168)

Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit

Tabela më poshtë përmbledh ekspozimin e Bankës ndaj rreziqeve të normës së interesit. Në tabelë janë të përfshira si aktivet dhe detyrimet financiare me norma interesi të pandryshueshme ashtu edhe ato me norma interesi të ndryshueshme.

31 Dhjetor 2016	Deri 1 muaj	1 deri 3 muaj	3 deri 6 muaj	6 deri 12 muaj	Mbi 1 vit	Pa interes	Totali
Aktive							
Mjete monetare dhe të ngjashme	-	-	-	-	-	4,017,943	4,017,943
Hua dhe paradhënie bankave	3,126,071	-	-	-	-	-	3,126,071
Investime në letra me vlerë	123,443	77,774	2,149,444	1,513,422	13,995,413	-	17,859,497
Hua dhe paradhënie për klientët	1,498,542	1,536,449	1,384,288	3,401,626	1,468,543	-	9,289,448
Aktive financiare të tjera	7,690	-	-	-	-	-	7,690
Totali	4,755,746	1,614,223	3,533,732	4,915,048	15,463,957	4,017,943	34,300,649
Detyrime							
Detyrime ndaj bankave	926,609	-	-	-	-	-	926,609
Detyrime ndaj klientëve	5,235,462	3,292,964	3,105,164	8,693,335	11,132,270	-	31,459,195
Borxhi i varur	4,404	78	1,405	-	1,086,022	-	1,091,909
Detyrime të tjera financiare	201,079	-	-	-	-	-	201,079
Totali	6,367,554	3,293,042	3,106,569	8,693,335	12,218,292	-	33,678,792
Hendeku i ndjeshmërisë së interesit më 31 Dhjetor 2016	(1,611,808)	(1,678,819)	427,163	(3,778,287)	3,245,665	4,017,943	621,857

31 Dhjetor 2015	Deri 1 muaj	1 deri 3 muaj	3 deri 6 muaj	6 deri 12 muaj	Mbi 1 vit	Pa interes	Totali
Aktive							
Mjete monetare dhe të ngjashme	-	-	-	-	-	4,910,984	4,910,984
Hua dhe paradhënie bankave	4,367,509	-	-	-	-	-	4,367,509
Investime në letra me vlerë	100,000	77,774	197,762	159,883	5,176,487	-	5,634,132
Hua dhe paradhënie për klientët	1,786,489	1,536,449	1,572,934	1,327,052	924,846	-	8,799,326
Aktive financiare të tjera	4,853	-	-	-	-	-	4,853
Totali	6,258,851	1,614,223	1,770,696	1,486,935	6,101,333	4,910,984	23,716,804
Detyrime							
Detyrime ndaj bankave	172,940	-	-	-	-	-	172,940
Detyrime ndaj klientëve	7,461,704	3,292,964	2,601,719	7,795,608	1,892,956	-	22,848,075
Borxhi i varur	617,739	78	-	-	-	-	1,113,597
Detyrime të tjera financiare	94,224	-	-	-	-	-	94,224
Totali	8,346,607	3,293,042	2,601,719	7,795,608	1,892,956	-	24,228,836
Hendeku i ndjeshmërisë së interesit më 31 Dhjetor 2015	(2,087,756)	(1,678,819)	(831,023)	(6,308,673)	4,208,377	4,910,984	(512,032)

d) Menaxhimi i Kapitalit

Rregullatori i Bankës, Banka Qëndrore e Shqipërisë, përcakton dhe monitoron kërkesat për kapital të Bankës. Politika e Bankës është ruajtja e kapitalit bazë brenda limiteve, duke kapitalizuar të gjitha fitimet në mënyrë që të mbështesi zhvillimet e ardhshme të biznesit duke njohur impaktin e nivelit të kapitalit në kthimin e aksionarëve. Banka njih nevojën të ruajë balancën midis kthimeve të larta të arritshme me një nivel më të lartë rreziku kundrejt avantazheve e sigurisë që krijojnë një pozicioni i fortë kapitali.

Në zbatim të kërkesave aktuale për Kapital, Banka e Shqipërisë kërkon që Banka të ruajë një normë të totalit të kapitalit të nivelit të parë dhe nivelit të dytë përmbi totalin e aktiveve dhe zërave jashtë bilancit të ponderuara me rrezikun mbi nivelin minimal prej 12%. Gjithashtu Banka duhet të ruajë një normë të totalit të kapitalit të nivelit të parë mbi nivelin minimal prej 6%. Gjatë vitit 2016 Banka

ka patur një normë të mjaftueshme e cila në 31 Dhjetor 2016 është 21.80% duke përfshirë kapitalin e nivelit të dytë (2015: 15.15%) dhe një normë të mjaftueshme për kapitalin e nivelit të parë prej 14.73% (2015: 10.10%).

Rregullorja e re mbi Raportin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit (RMK), dalë në Mars 2015, e llogarit RMK bazuar në kriterin e Basel II, në përputhje me Direktivat Europiane për Institucionet Financiare. Pavarësisht rritjes së vlerës së aktiveve të ponderuara me rrezikun si rezultat i rregullores së re dhe masave kunderciklike, RMK e Bankës ka qënë kështu mbi nivelin minimal rregullator të përcaktuar. Politika e ndjekur nga Banka është ruajtja e një kapitali bazë të fortë në mënyrë që të ruajë besimin e investitorëve, kreditorëve dhe tregut si edhe të mbështesi zhvillimet e ardhshme të biznesit.

Për periudhën raportuese nivelet e kapitalit të Bankës, aktivet e ponderuara me rrezikun dhe raporti i mjaftueshmërisë sipas Bankës së Shqipërisë janë si vijon:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Kapitali i nivelit të parë		
Kapitali i paguar	7,708,537	7,708,537
Rezerva të tjera	(46,816)	22,908
Rezeva ligjore dhe rregullatore	57,162	57,162
Rezultati i akumuluar	(5,276,329)	(6,017,050)
	2,442,554	1,771,557
Zbritjet		
Aktivet e patrupëzuara	(166,937)	(199,602)
Totali i kapitalit të nivelit të parë	2,275,617	1,571,955
Shtesa		
Borxhi i varur	1,091,909	785,978
Totali i kapitali të niveli të dytë	1,091,909	785,978
Kapitali Rregullator	3,367,526	2,357,933
Aktivet e ponderuara me rrezikun	15,447,896	15,563,969
Totali i aktiveve të ponderuara me rrezikun	15,447,896	15,563,969
Kapitali Rregullator ndaj Aktiveve të ponderuara me rrezikun	21.80%	15.15%
Kapitali i nivelit të parë ndaj Aktiveve të ponderuara me rrezikun	14.73%	10.10%

Për të përmirësuar treguesit e kapitalizimit të Bankës, me efektivitet nga data 29 Mars 2017, pjesa prej EUR 2.03 milion u transferua nga Borxhi i Varur në Kapital të Paguar të Bankës. Borxhi i varur u ul nga EUR 8.03 milion në 6.00 milion dhe njëkohësisht Kapitali i Paguar i Bankës u rrit me të njëjtën shumë.

6 | PËRMBLEDHJE E VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE KONTABËL

Banka bën vlerësime dhe supozime që mendohet se do prekin vlerat e raportuara brenda vitit të ardhshëm financiar. Vlerësimet dhe supozimet analizohen vazhdimisht dhe bazohen në informacionet e tregut ose faktorë të tjerë të lidhur, përfshirë pritshmëri për ngjarje të mundshme të ardhme që besohet në mënyrë të arsyeshme të ndodhin në rrethanat aktuale.

(i) Humbjet nga zhvlerësimet për huatë dhe paradhëniet

Banka rishikon dhe analizon huatë dhe paradhëniet dhënë klientëve në baza mujore. Për të vlerësuar nëse humbje nga zhvlerësimi duhet të regjistrohen në fitim humbje Banka gjykon nëse ka evidencë që tregon një rënie të ne vlerësimin e flukseve të ardhshme të parasë nga një pjesë e portofolit të kredisë përpara se rënia të identifikohet në kredi specifike të këtij portofoli.

Kjo evidencë mund të përfshijë të dhëna që tregojnë një ndryshim negativ në situatën e pagesave dhe financiare të huamarrësit apo në kushtet ekonomike kombëtare apo lokale, që lidhen me problemet që shfaqin aktivet e Bankës. Drejtimi i Bankës përdor supozime dhe vlerësime bazuar në informacionet e tregut, standartet krahasimore nga industria si dhe indikatorë të tjerë të zhvlerësimin për aktive me karakteristika të ngjashme të rrezikut të kredisë me aktivet që disponon Banka.

(ii) Vlera neto e realizueshme e inventarit

Banka ka vendosur një politikë për sa i përket vlerës së drejtë të kolateraleve të riposeduara, që maten me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Matja e vlerës neto të realizueshme përfshin vlerësimin e inventarit nga vlerësues të jashtëm pronash, të pajisur me kualifikimet e duhura profesionale ligjore, vlerësim i cili më tej rishikohet nga Drejtimi i Bankës për të identifikuar informacione të rëndësishme të pamatshme apo për të vlerësuar nevojën të mundshme për shtesa në zhvlerësim.

(iii) Vlerësimi i instrumenteve financiare

Vlerësimi i instrumenteve financiare paraqitet në politikën kontabël 3.g.vi.

Banka përdor hierarkinë e mëposhtme për përcaktimin dhe pasqyrimin e vlerës së drejtë të instrumenteve financiare nëpërmjet teknikës së vlerësimin:

-Niveli 1: Çmime të kuotuar (të parregulluara) në tregje aktive për instrumenta identike;

-Niveli 2: Teknika vlerësimi bazuar në të dhëna të vëzhgueshme, në mënyrë të drejtpërdrejtë (p.sh. çmimet) ose indirekte (p.sh. që rrjedhin nga çmimet). Kjo kategori përfshin instrumente të vlerësuar duke përdorur: çmime të kuotuar në një treg aktiv për instrumenta të ngjashme; çmime të kuotuar për instrumenta identike ose të ngjashme në një treg që konsiderohet më pak aktiv; ose teknika të tjera vlerësimi ku të gjitha informacionet e rëndësishme janë të vëzhgueshme në treg.

-Niveli 3: Teknika vlerësimi që përdorin informacione të rëndësishme jo të identifikueshme apo vërejtshme në treg. Kjo kategori përfshin të gjithë instrumentet ku teknika e vlerësimin përfshin informacione jo të bazuara në të dhënat e vëzhgueshme të tregut dhe ndërkohë këto të dhëna kanë një efekt të rëndësishëm në vlerësimin e instrumenteve.

Teknikat e vlerësimin përfshijnë vlerën aktuale neto dhe modele të aktualizimit të fluksit të parave, krahasimin me instrumenta të ngjashëm për të cilët çmimet e observueshme të tregut ekzistojnë dhe bazohen në kurbën aktuale të interesave të përfitueshme të përshtatshme për afatin e maturimit të mbetur.

Supozimet dhe të dhënat e përdorura në teknikat e vlerësimin përfshijnë norma interesi pa rrezik, marzhe kreditorë dhe premium të tjera të përdorura në vlerësimin e normave të skontimit, obligacioneve dhe cmimeve të kapitalit, normave të kurseve të këmbimit, cmimeve të kapitalit si dhe korrelacioneve dhe luhatshmërive të pritshme të cmimeve. Qëllimi i teknikave të vlerësimin është të përcaktojë vlerën e drejtë të instrumentit financiar duke reflektuar cmimin i cili do të ishte vendosur nga tregu sipas parimit "at arm's length transaction"

Banka përdor modelet e vlerësimin të njohura gjerësisht për përcaktimin e vlerës së drejtë dhe përdor vetëm të dhëna të vëzhgueshme të tregut që kërkojnë pak gjykim dhe vlerësim nga drejtimi. Çmimet e vëzhgueshme dhe informacionet e modelit janë zakonisht të disponueshme dhe vëzhgueshme në treg për instrumentet e listuara

të borxheve dhe kapitalit. Disponibiliteti i çmimeve të vëzhgueshme të tregut redukton nevojën për gjykime dhe vlerësime nga drejtimi dhe gjithashtu redukton pasigurinë që shoqëron përcaktimin e vlerave. Disponibiliteti i të dhënave të tregut varet nga tipet e produkteve dhe tregjeve dhe është i prirur ndaj ndryshimeve në varësi të ngjarjeve specifike dhe kushteve të përgjithshme të tregjeve financiare.

Në 31 Dhjetor 2016 dhe 2015 të gjithë instrumentat financiarë mbahen me kosto të amortizuara me përjashtim të letrave me vlerë të vlefshme për shitje të cilat mbahen me vlerë të drejtë, e cila paraqitet në mënyrë të detajuar në shënimin 6.

(v) Rreziku nga çështjet gjyqësore

Drejtimi i Bankës ka hartuar një proces të brendshëm për njohjen dhe matjen e provizioneve dhe detyrimeve të kushtëzuara për çështje gjyqësore ekzistuese ose të pritshme. Vlerësimet dhe supozimet kryesore në lidhje me mundësinë dhe sasinë e një fluksi dalës burimesh bazohen në analiza ligjore të brendshme dhe të jashtme duke ndjekur strategjitë përkatëse të mbrojtjes së

suksesshme ndaj veprimeve që mund të rezultojnë. Çdo veprim së bashku me rrezikun përkatës matet në varësi të elementëve, bazës dhe detyrimeve ligjore të pretenduara si dhe vlerësimet e flukseve të parashikuara monetare që gjykohen të pagueshme aprovohen në mënyrë të pavarur nga Drejtori Ekzekutiv i Bankës. Drejtimi i Bankës beson se detyrime ligjore aktuale apo të ardhshme janë ngjarje me probabilitet të ulët, megjithatë për shkak arsyesh përtej kuadrit ligjor, rreziqe potenciale mund të ekzistojnë.

(vi) Përcaktimi i kontrollit mbi investimet

Manaxhimi bazohet në gjykimin e tij për të përcaktuar nëse Banka kontrollon investimet. Për të vlerësuar nëse Banka kontrollon investimet, Banka kryen analiza duke konsideruar qëllimin dhe formën e investimit, evidencën e aftësisë praktike për të drejtuar aktivitetet relevante të investimit etj.

Si rezultat, Banka konkludon se ajo nuk kontrollon dhe rrjedhimisht nuk duhet të konsolidojë njësitë për qëllime të veçanta dhe njësitë e veta ekonomike me të arketueshme në vonesë, pasi Banka nuk ushtron vendimarrje mbi aktivitetet përkatëse të këtyre subjekteve.

AKTIVET DHE PASIVET FINANCIARE

Tabela më poshtë tregon vlerën kontabël dhe vlerën e drejtë të aktiveve dhe pasiveve financiare të Bankës.

Shënim	Vlera Kontabël				Vlera e Drejtë				
	Hua dhe paradhënie	Investime në letra me vlerë	Detyrime të tjera financiare	Totali i vlerës kontabël	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Totali	
31 Dhjetor 2016									
Hua dhe paradhënie klientëve	10	9,289,448	-	-	9,289,448	-	8,321,684	-	8,321,684
Letra me vlerë të investimit	9	-	6,888,858	-	6,888,858	-	6,409,616	-	6,409,616
Letra me vlerë të vendosjes	9	-	10,970,639	-	10,970,639	-	10,970,639	-	10,970,639
Totali		9,289,448	17,859,497	-	27,148,945	-	25,701,939	-	25,701,939
Detyrime ndaj klientëve	16	-	-	31,459,195	31,459,195	-	31,774,602	-	31,774,602
Total		-	-	31,459,195	31,459,195	-	31,774,602	-	31,774,602
31 Dhjetor 2015									
Hua dhe paradhënie klientëve	10	8,799,326	-	-	8,799,326	-	8,047,543	-	8,047,543
Investime në letra me vlerë	9	-	5,634,132	-	5,634,132	-	5,634,132	-	5,634,132
Totali		8,799,326	5,634,132	-	14,433,458	-	13,681,675	-	13,681,675
Detyrime ndaj klientëve	16	-	-	22,848,075	22,848,075	-	22,988,214	-	22,988,214
Totali		-	-	22,848,075	22,848,075	-	22,988,214	-	22,988,214

Kreditë dhe paradhëniet ndaj institucioneve financiare përfshinë depozitat ndërbankare dhe aktive të tjera të mbledhshme. Për shkak se kreditë, paradhëniet dhe depozitat njëditore janë afatshkurtra dhe me norma variabël interesi, vlera e tyre e tregut konsiderohet e njëjtë me atë kontabël. Në vlerësimin e vlerës së drejtë të portofolit të kredive, Banka merr në konsideratë faktorë të krahasueshëm të tregut si për shembull normat e interesit. Megjithatë për shkak të natyrës së sistemit të

informacionit të Bankës, dhe natyrës së larmishme të portofolit të kredisë, vlera e drejtë e vlerësuar përfshin pasiguri të konsiderueshme. Banka llogarit vlerën e drejtë të investimeve në letra me vlerë duke konsideruar të dhënat e vëzhgueshme të tregut për instrumente të ngjashme ose identike.

Vlera e drejtë e depozitave të klientëve është vlerësuar duke aktualizuar flukset monetare bazuar në normat e tregut për maturimin e mbetur.

7. MJETET MONETARE DHE TE NGJASHME

Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to për 31 Dhjetor 2016 and 31 Dhjetor 2015 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Arka	841,499	823,055
Llogari të pakufizuara me Bankën Qëndrore	3,176,444	4,087,929
Totali	4,017,943	4,910,984

8. HUA DHE PARADHËNIE BANKAVE

Hua dhe paradhënie dhënë bankave më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015 përbëhen nga:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Depozita në banka korrespondente	581,359	804,850
Vendosjet në tregun monetar	-	1,490,073
Rezerva e detyrueshme me Bankën e Shqipërisë	2,544,712	2,072,586
Totali	3,126,071	4,367,509

Në përputhje me kërkesat e Bankës së Shqipërisë, Banka duhet të mbajë një rezervë minimale në masën 10% të depozitave të klientëve me afat maturimi fillestar deri në dy vjet si rezervë të detyrueshme pranë Bankës Qëndrore. Këto rezerva mbahen në monedha që përputhen me balancat përkatëse të detyrimeve ndaj klientëve. Shuma e nevojshme për tu depozituar llogaritet në bazë mujore. Sipas rregullores së Bankës së Shqipërisë, 40% e kësaj

rezerve në lekë është në dispozicion për përdorim të përditshëm nga Banka.

Interesi mbi rezervën e detyrueshme në Lek është 70% e normës së marrëveshjes së riblerjes. Balanca në Lek ka një normë interesi 0.875% në vit për 31 Dhjetor 2016 (31 Dhjetor 2015: 1.225% në vit).

Shpërndarja gjeografike e kredive dhe paradhënieve dhënë bankave është si më poshtë:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Shqipëri	2,568,133	3,562,659
Gjermani	-	636,850
SHBA	-	87,675
Francë	556,506	80,324
Greqi	1,432	-
Totali	3,126,071	4,367,509

Hua dhe paradhënie dhënë bankave në Francë më 31 Dhjetor 2016 përfaqësojnë kryesisht llogari të bllokuara si garanci ndaj një Letër Kredie të lëshuar nga Banka në mbështetje të një transaksioni tregtar të një klienti të saj, të zhbllokuar plotësisht më 24 Mars 2017.

9. INVESTIME FINANCIARE NË LETRA ME VLERË

Investime në letra me vlerë të vendosjes

Investimet në letra me vlerë të vendosjes më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015 detajohen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Qeveria Shqiptare		
Jo të listuara	10,970,639	5,634,132
Total	10,970,639	5,634,132

Banka rishikon instrumentet e saj të borxhit të klasifikuara si investime të vlefshme për shitje në çdo datë bilanci në mënyrë që të vlerësojë nëse ka ndonjë mundësi objektive që ato mund të jenë zhvlerësuar .

Në 31 Dhjetor 2016, letra me vlerë të vendosjes në vlerën Lek 1,000,000 mijë (2015: Lek 200,000 mijë) janë vendosur si kolateral il marrëveshje së riblerjes

Investime në letra me vlerë të investimit

Investimet në letra me vlerë të investimit në 31 Dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 mund të detajohen si vijon:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Qeveria Shqiptare		
Jo të listuara	6,888,858	-
Total	6,888,858	-

Riklasifikimi i letrave me vlerë nga të vendosjes në të investimit

Prej datës 1 Tetor 2016, Banka ka riklasifikuar me vlerë të drejtë disa prej letrave me vlerë të klasifikuara të vendosjes në atë datë , për të cilat ka ndryshuar qëllimin e saj duke i mbajtur këto aktive financiare deri në maturim. Për riklasifikimin e letrave me vlerë të vendosjes që do të zbatojnë përcaktimin e mbajtjes deri në maturim, Banka ka qëllimin dhe aftësinë të mbajë deri në maturim. Tabela më poshtë tregon aktivet financiare të riklasifikuara dhe vlerën e tyre kontabel dhe të drejtë:

	Vlerat e riklasifikuara në 2016	Vlera kontabël 31 Dhjetor 2016	Vlera e drejtë 31 Dhjetor 2016
Aktivet e riklasifikuara në 2016			
Letrat me vlerë të vendosjes të riklasifikuara si letra me vlerë të investimit	6,849,203	6,888,858	6,409,616
Total	6,849,203	6,888,858	6,409,616

Tabela më poshtë paraqet vlerat e njohura aktualisht në fitim/humbje dhe në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse në 2016 lidhur me aktivet financiare të riklasifikuara nga kategoria letra me vlerë të vendosjes në kategorinë letra me vlerë të investimit:

	Riklasifikimi në 2016	
	Fitim/humbja në 2016	Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse në 2016
Letrat me vlerë të vendosjes të riklasifikuara si letra me vlerë të investimit		
Të ardhura nga interesi	275,673	-
Amortizimi i rezervës	1,600	-
Total	277,273	-

Tabela më poshtë paraqet vlerat që do të ishin njohur në fitim/humbje ose në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse në 2016 nëse aktivet financiare nuk do të ishin riklasifikuar:

	Riklasifikimi në 2016	
	Fitim/humbja në 2016	Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse në 2016
Letrat me vlerë të vendosjes të riklasifikuara si letra me vlerë të investimit		
Të ardhura nga interesi	277,273	-
Rezerva e vlerës së drejtë	-	(479,242)
Total	277,273	(479,242)

Norma efektive e interesit e aktiveve të riklasifikuara nga kategoria letra me vlerë të vendosjes në kategorinë letra me vlerë të investimit prej datës 1 Tetor 2016 dhe të mbajtura ende në datën e raportimit varion nga 2.3% në 8.8%, me flukse monetare të arkëtueshme të pritshme prej Lek 6,889 milion

10. HUA DHE PARADHËNIE DHËNË KLIENTËVE

Huatë dhe paradhëniet ndaj klientëve më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Hua	7,469,056	6,588,682
Ovërdrafte	2,911,787	3,397,863
Komisione disbursimi të shtyra	(32,485)	(28,817)
Vlera Bruto	10,348,358	9,957,728
Fondi i zhvlerësimit	(1,058,910)	(1,158,402)
Vlera totale neto	9,289,448	8,799,326

Lëvizjet në fondin e zhvlerësimit të huave dhe paradhënieve ndaj klientëve paraqiten si më poshtë:

	2016	2015
Zhvlerësimet specifike		
Gjëndja më 1 Janar	899,751	3,028,321
Shpenzime për periudhën	502,482	292,633
Rimarrje provizionesh për kreditë	(540,697)	(194,655)
Rimarrje provizionesh për kreditë e fshira	(56,523)	(2,170,658)
	(94,738)	(2,072,680)
Diferenca konvertimi	(12,747)	(55,890)
Gjëndja më 31 Dhjetor	792,266	899,751
Kredi të fshira	238,035	4,149,931
Rekupërimet nga kreditë e fshira	(488,090)	(10,455)
Rekupërimet nga kolateratet e riposeduara	(32,380)	(6,171)
	(282,435)	4,133,305
Shpenzimi i vitit për provizionet specifike	(377,173)	2,060,625



	2016	2015
Zhvlërësime kolektive		
Gjëndja më 1 Janar	258,651	295,802
Shpenzime për periudhën	149,023	137,235
Rimarrje provizionesh për kreditë	(137,619)	(185,426)
Shpenzime për periudhën nga zhvlëresimet kolektive	11,404	(48,191)
Diferenca konvertimi	(3,410)	(5,973)
Lëvizje të tjera (shënimi 18)	-	17,014
Gjëndja më 31 Dhjetor	266,645	258,651
Totali i fondit të zhvlërësimit	1,058,911	1,158,402
Shpenzimi i zhvlërësimit të vitit	(365,769)	2,012,434

11. NDËRTESTA DHE PAJISJE

Ndërtesat dhe pajisjet më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015 janë si më poshtë:

	Ndërtesa	Pajisje elektronike	Pajisje zyre	Mjete transporti	Përmirësime të ambienteve me qera	Aktive në proces	Totali
Kosto							
Më 1 Janar 2015	412,022	391,382	116,367	47,708	457,844	-	1,425,323
Shtesa	414	15,210	574	-	7,300	20,625	44,123
Pakësime	-	-	-	-	-	-	-
Transferime	-	3,533	-	-	-	(3,533)	-
Më 31 Dhjetor 2015	412,436	410,125	116,941	47,708	465,144	17,092	1,469,446
Shtesa	2,257	5,120	2,347	-	29,414	-	39,138
Pakësime	-	(34,970)	-	(5,116)	-	-	(40,086)
Transferime	-	17,092	-	-	-	(17,092)	-
Më 31 Dhjetor 2016	414,693	397,367	119,288	42,592	494,558	-	1,468,498
Amortizimi i akumuluar							
Më 1 Janar 2015	(164,905)	(314,861)	(100,702)	(44,540)	(292,002)	-	(917,010)
Shpenzimi i vitit	(8,513)	(35,026)	(5,330)	(1,188)	(44,295)	-	(94,352)
Pakësime	-	-	-	-	-	-	-
Më 31 Dhjetor 2015	(173,418)	(349,887)	(106,032)	(45,728)	(336,297)	-	(1,011,362)
Shpenzimi i vitit	(8,555)	(33,601)	(5,153)	(1,188)	(18,109)	-	(66,606)
Pakësime	-	34,395	-	5,116	-	-	39,511
Më 31 Dhjetor 2016	(181,973)	(349,093)	(111,185)	(41,800)	(354,406)	-	(1,038,457)
Vlera kontabël neto							
Më 31 Dhjetor 2015	239,018	60,238	10,909	1,980	128,847	17,092	458,084
Më 31 Dhjetor 2016	232,720	48,274	8,103	792	140,152	-	430,041

12. AKTIVET AFATGJATA JO-MATERIALE

	Programe Kompjuterike	Në proces	Totali
Kosto			
Më 1 Janar 2015	500,977	6,537	507,514
Shtesa	8,867	34,241	43,108
Transferime	1,940	(1,940)	-
Riklasifikime në aktive materiale & Opex	-	(1,064)	(1,064)
Më 31 Dhjetor 2015	511,784	37,774	549,558
Shtesa	12,547	7,129	19,676
Transferime	43,970	(43,970)	-
Riklasifikime në aktive materiale & Opex	-	-	-
Më 31 Dhjetor 2016	568,301	933	569,234
Amortizimi i akumuluar			
Më 1 Janar 2015	(329,357)	-	(329,357)
Shpenzime të vitit	(37,692)	-	(37,692)
Pakësime	-	-	-
Më 31 Dhjetor 2015	(367,049)	-	(367,049)
Shpenzime të vitit	(35,248)	-	(35,248)
Pakësime	-	-	-
Më 31 Dhjetor 2016	(402,297)	-	(402,297)
Vlera neto kontabël			
Më 31 Dhjetor 2015	144,735	37,774	182,509
Më 31 Dhjetor 2016	166,004	933	166,937

13. INVENTARI DHE MJETE TË TJERA

Aktivët e tjera më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Aktive të marra në zotërim	1,936,402	1,993,123
Pagesa në proces dhe aktive të tjera	7,690	4,852
Debitorë të ndryshëm	28,643	28,389
Shpenzime të parapaguara	46,262	41,055
Totali	2,018,997	2,067,419

Inventari përfaqëson pronat e rimarra në zotërim si rezultat i procesit të arkëtimit të huave me probleme. Lëvizjet në "kolaterale të riposeduara" për periudhën e raportimit janë si më poshtë:

	2016	2015
Në fillim të periudhës	1,993,123	2,254,573
Shtesa gjatë periudhës	32,641	47,997
Pakësime	(89,365)	(269,108)
Zhvlërësimi i inventarit	-	(48,818)
Efekt i kursit të këmbimit valutor	3	8,479
Në fund të periudhës	1,936,402	1,993,123

14. DETYRIME NDAJ BANKAVE

Aktivitet e tjera më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Banka korrespondente		
Llogari rrjedhëse	-	9
Rezidente	-	9
Marrëveshje të Riblerjes	926,609	172,931
Totali	926,609	172,940

Marrëveshjet e riblerjes më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015 detajohen si më poshtë:

31 Dhjetor 2016					
Maturimi	Norma e interesit	Vlera nominale	Interesi i përlogaritur	Vlera kontabël	
05/01/2017	1.26%	1,000,000	(96)	926,609	
Totali		1,000,000	(96)	926,609	

31 Dhjetor 2015					
Maturimi	Norma e interesit	Vlera nominale	Interesi i përlogaritur	Vlera kontabël	
25/1/2016	2.16%	100,000	(343)	86,845	
25/1/2016	2.16%	100,000	(340)	86,086	
Totali		200,000	(683)	172,931	

Në 31 Dhjetor 2016, Banka ka vendosur si kolateral për marrëveshje të riblerjes letra me vlerë të vlefshme për shitje në shumën Lek 1,000,000 mijë (2015: 200,000 mijë) (shënimi 9).

Këto transaksione janë kryer nën kushtet e zakonshme të investimeve në letra me vlerë dhe kredidhënies dhe gjithashtu bazuar në kushtet e përcaktuara nga Banka Qëndrore e Shqipërisë.

15. DETYRIME NDAJ KLIENTËVE

Detyrimet ndaj klientëve më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2016			31 Dhjetor 2015		
	Monedha vendase	Monedhë e huaj	Totali	Monedha vendase	Monedhë e huaj	Totali
Llogari rrjedhëse						
Individë	723,870	1,249,861	1,973,731	1,188,846	2,276,966	3,465,812
Korporata	2,306,951	704,823	3,011,774	1,662,316	311,858	1,974,174
	3,030,821	1,954,684	4,985,505	2,851,162	2,588,824	5,439,986
Depozita						
Individë	13,313,013	10,859,506	24,172,519	8,115,599	7,629,344	15,744,943
Korporata	1,635,975	665,196	2,301,171	734,839	928,307	1,663,146
	14,948,988	11,524,702	26,473,690	8,850,438	8,557,651	17,408,089
Totali	17,979,810	13,479,386	31,459,195	11,701,600	11,146,475	22,848,075

Tepricat e detyrimeve ndaj klientëve sipas maturimit dhe llojit të monedhës janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2016			31 Dhjetor 2015		
	Monedha vendase	Monedhë e huaj	Totali	Monedha vendase	Monedhë e huaj	Totali
Llogari rrjedhëse	3,030,822	1,954,684	4,985,506	2,851,162	2,588,824	5,439,986
Depozita						
1 mujore	1,249,633	2,728,836	3,978,469	70,379	233,228	303,607
3 mujore	142,596	294,833	437,429	119,781	351,837	471,618
6 mujore	1,713,919	301,527	2,015,446	371,856	525,415	897,271
9 mujore	3,062	13,443	16,505	6,975	9,898	16,873
12 mujore	6,749,852	6,166,575	12,916,427	5,904,512	5,717,394	11,621,906
18 mujore	8,420	4,021	12,441	885,869	976,496	1,862,365
24 mujore	1,830,156	1,083,023	2,913,179	976,662	456,064	1,432,726
36 mujore	1,748,826	629,022	2,377,848	514,404	287,319	801,723
60 mujore	794,588	303,420	1,098,008	-	-	-
84 mujore	691,746	-	691,746	-	-	-
120 mujore	16,191	-	16,191	-	-	-
	14,948,989	11,524,700	26,473,689	8,850,438	8,557,651	17,408,089
Totali	17,979,810	13,479,384	31,459,195	11,701,600	11,146,475	22,848,075

16. BORXHI I VARUR

Detyrimet ndaj klientëve më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Credit Agricole S.A	-	-
Tranzit Sh.p.k	1,091,909	1,113,597
Totali	1,091,909	1,113,597

Në Tetor 2015, të gjitha të drejtat dhe detyrimet mbi borxhin e varur të dhënë nga Credit Agricole S.A u transferuan tek Tranzit Shpk. Në 31 Dhjetor 2016 dhe 2015 detyrimet e varura mbartin interesat dhe maturitetet e mëposhtme:

31 Dhjetor 2016			
Monedha	Vlera	Maturimi	Norma e Interesit
EUR	2,500,444	2033	1.70%
EUR	1,100,480	2033	2.10%
EUR	4,430,000	2033	3.35%
Totali	8,030,924		
31 Dhjetor 2015			
EUR	2,500,444	2021	Euribor+1.7%
EUR	1,100,480	2019	Euribor+2.1%
EUR	4,430,000	2020	Euribor+7%
Totali	8,030,924		

Të drejtat kontraktuale dhe detyrimet e borxheve të varura u ristrukturuar më 1 prill 2016, duke zgjatur periudhën e maturimit deri në vitin 2033 me norma interesi fikse.

Detyrimet e mësipërme në rast të likuidimit të emetuesit, do të jenë në vartësi të kërkesave të depozituesve dhe të gjithë kreditorëve të tjerë të emetuesit.

Banka nuk ka patur vonesa në pagesat e principalit ose interesit apo shkelje të tjera në lidhje me detyrimet e saj të varura gjatë viteve të mbyllur më 31 Dhjetor 2016 dhe 2015.

17. AKTIVE TATIMORE TË SHTYRA

Aktivet dhe detyrimet tatimore të shtyra janë njohur për zërat e mëposhtëm:

	31 Dhjetor 2016			31 Dhjetor 2015		
	Aktivet	Detyrimet	Neto	Aktivet	Detyrimet	Neto
Paisjet dhe aktivet afatgjata jomateriale	3,168	-	3,168	3,884	-	3,884
Aktivet tatimore të shtyra neto	3,168	-	3,168	3,884	-	3,884
Letra me vlerë të vlefshme për shitje	-	(81,314)	(81,314)	-	-	-
Detyrime tatimore të shtyra neto	-	(81,314)	(81,314)	-	-	-

Lëvizjet në diferencat e përkohshme gjatë vitit janë si vijon:

	Gjendja në fillim	Njohur në fitim ose në humbje	Njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	Aktivet tatimore të shtyra	Detyrime tatimore të shtyra
31 Dhjetor 2016					
Paisjet dhe aktivet afatgjata jomateriale	3,884	(716)	-	3,168	-
Letra me vlerë të vlefshme për shitje	-	-	(81,314)	-	(81,314)
Totali	3,884	(716)	(81,314)	3,168	(81,314)
31 Dhjetor 2015					
Paisjet dhe aktivet afatgjata jomateriale	4,802	(918)	-	3,884	-
Totali	4,802	(918)	-	3,884	-

18. PROVIZIONE TË TJERA

Lëvizjet në provizione gjatë vitit janë si më poshtë:

	Për çështje gjyqore	Për zërat jashtë bilancit	Provizione të tjera	Total
Gjendja në 31 Dhjetor 2015	20,622	5,062	24,414	50,098
Provizione të llogaritura gjatë vitit	(1,916)	3,083	9,291	10,458
Rrimarrje provizionesh	(3,312)	-	(1,102)	(4,414)
Efektet nga lëvizjet në kursin e këmbimit	(207)	(68)	(120)	(395)
Gjendja në 31 Dhjetor 2016	15,187	8,077	32,483	55,747

Provizionet e tjera përfshijnë provizione për humbje nga llogaritë me status jo aktiv dhe llogaritë rrjedhëse me balanca debitorë.

19. DETYRIME TË TJERA

Detyrimet e tjera më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015 përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Pagesa në proces	173,120	47,630
Detyrime ndaj furnitorëve	49,829	47,361
Kreditorë të ndryshëm	121,693	17,020
Sigurime shoqërore për t'u paguar	15,797	17,734
Të tjera	12,162	28,859
	372,601	158,604

20. KAPITALI AKSIONAR

Kapitali aksionar i autorizuar, i emetuar dhe i paguar plotësisht i Bankës më 31 Dhjetor 2015 përbëhet nga aksione të zotëruara 100% nga Tranzit Shpk pas shitjes të pjesëmarrjes prej 100% të IUB Holding (Credit Agricole S.A) (referuar gjithashtu shënimit nr. 1).

Kapitali aksionar i regjistruar më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015 është si vijon:

Më 31 Dhjetor 2016	Monedha	Nr i aksioneve	Vlera Nominale	Në monedhë origjinale	Në Lek '000
	LEK	56,111	112,445.54	6,309,426,455	6,309,426
	EUR	12,312	812.08	9,998,329	1,399,111
		68,423			7,708,537
Më 31 Dhjetor 2015	Monedha	Nr i aksioneve	Vlera Nominale	Në monedhë origjinale	Në Lek '000
	LEK	32,179	114,691.54	3,690,659,139	3,690,659
	EUR	36,244	812.08	29,433,028	4,017,878
		68,423			7,708,537

Numri i aksioneve më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015 paraqitet si më poshtë:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Numri i aksioneve të autorizuar dhe paguara plotësisht në fillim të vitit	68,423	61,774
Numri i aksioneve të emetuara gjatë vitit	-	6,649
Numri i aksioneve të autorizuar dhe paguara plotësisht në fund të vitit	68,423	68,423

Si pasojë e humbjeve të mbartura, gjatë vitit 2015 dhe 2016 nuk janë deklaruar apo shpërndarë dividendë.

21. REZERVA LIGJORE

Banka duhet të krijojë një rezervë rregullatore prej 1.25% deri në 2% të totalit të asetëve të ponderuara me rrezik, duke përvetësuar një të pestën e fitimit neto dhe para pagesës së dividendëve, derisa balanca në këtë masë të arrijë të paktën 1.25% të totalit të asetëve të ponderuara me rrezik dhe një rezervë ligjore prej 5% të të ardhurave neto të Bankës pas zbritjes së humbjeve të akumuluar të viteve të mëparshme, derisa balanca e kësaj rezerve arrin 10% të kapitalit aksioner të bankës, por këto rezerva nuk i shpërndahen aksionarëve. Rezerva ligjore më 31 Dhjetor 2016 është Lek 57,162 mijë (2015: 57,162 mijë).

22. REZERVA TË VLERËS SË DREJTË

Rezervat e tjera përfaqësojnë rezervat nga vlera e drejtë të krijuara nga ndryshimi kumulativ neto në vlerën e drejtë të investimeve në letra me vlerë të vlefshme për shitje deri në momentin kur aktivi financiar fshihet ose zhvlerësohet. Ndryshimet gjatë vitit financiar të mbyllur më 31 Dhjetor 2016 janë rritur me Lek 424,793 mijë (2015: rritur me Lek 46,737 mijë).

23. TË ARDHURA NETO NGA INTERESAT

Të ardhura nga interesat	2016	2015
Hua dhe paradhënie ndaj klientëve	572,405	917,572
Hua dhe paradhënie ndaj bankave	7,813	15,852
Investime financiare në letra me vlerë	734,020	80,251
Totali	1,314,238	1,013,675
Shpenzimet për interesa		
Depozita me dhe pa afat	364,045	301,763
Detyrime ndaj bankave	17,695	12,621
Borxhi i varur	35,883	29,738
Llogari Rrjedhëse të klientëve	25,994	25,739
Totali	443,617	369,861
Të ardhura neto nga interesat	870,621	643,814

Të ardhurat nga interesat për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016 të lidhura me huatë dhe paradhëniet e zhvlerësuaru dhënë klientëve janë Lek 119 milion (2015: Lek 374 milion).

24. TË ARDHURA NETO NGA KOMISIONET

	2016	2015
Shërbime arkëtimesh e pagesash	28,976	39,290
Llogaritë rrjedhëse	35,539	33,736
Kartat dhe POS-et	13,769	13,656
Garanci të dhëna	29,369	8,961
Shërbime bankare me internet	91	33
Tarifa për marrëveshje dhe tarifa të tjera	30,597	32,650
Të ardhura nga tarifat dhe komisionet	138,341	128,326
ATM dhe kartat	5,025	23,475
Shërbime të tjera bankare	2,757	781
Shërbime arkëtimesh e pagesash	10,488	11,203
Garanci të marra	-	17,340
Shpenzime për tarifa dhe komisione	18,270	52,799
Të ardhura neto nga tarifat dhe komisionet	120,071	75,527

Tarifat dhe komisionet nuk përfshijnë komisionet e marra nga kreditë dhe paradhëniet ndaj klientëve (kostot e transaksioneve), të cilat rregullohen në njohjen fillestare të vlerës së mbartur të këtyre aktiveve financiare sipas metodës së normës efektive të interesit.

25. TË ARDHURA TË TJERA, NETO

	2016	2015
Fitimet/(humbjet) nga transaksionet valutore, neto	41,460	(58,862)
Totali	41,460	(58,862)

26. TË ARDHURA TË TJERA OPERATIVE, NETO

	2016	2015
Fitim nga shitja e paisjeve	10,873	-
Fitime të tjera operative,neto	2,187	3,501
Totali	13,060	3,501

27. SHPENZIMET E PËRSONELIT

	2016	2015
Paga dhe bonuse	349,978	438,772
Sigurimet Shoqërore	37,341	36,571
Trainime dhe shpenzime të tjera të ngjashme	7,394	40,750
Totali	394,713	516,093

28. SHPENZIME TË TJERA ADMINISTRATIVE

	2016	2015
Mirëmbajtje e riparime për paisje e ndërtesa	35,400	89,396
Licenca IT, mirëmbajtje e programeve kompjuterike	47,529	83,390
Konsulencë ligjore e profesionale	49,809	50,637
Reklama e publikime	73,051	37,558
Internet e komunikim	9,907	22,964
Pastrimi	816	18,122
Mirëmbajtje për kolaterale të riposeduara	4,105	17,154
Karta	14,765	15,385
Udhëtime pune	9,373	14,664
Telefoni dhe energji elektrike	5,033	12,568
Reuters	8,972	9,876
Kancelari	7,096	8,310
Sigurime	4,409	6,220
Taksa e tarifa lokale	9,390	5,580
Shërbime transporti dhe sigurie	5,690	4,612
Shpenzime përfaqësimi	3,088	4,055
Primi i sigurimit të depozitave	65,465	52,340
Të tjera	5,606	23,925
Totali	359,503	476,756

29. TATIM FITIMI

Shpenzimi i tatim fitimit për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015 përbëhet si më poshtë:

	2016	2015
Viti aktual	-	-
Rregullime për vitin e mëparshëm	-	-
Shpenzimi aktual i tatim fitimit	-	-
Efeti tatimor si rezultat i diferencave të përkohshme	(716)	(918)
Tatimi i shtyrë	(716)	(918)
Shpenzimi i tatim fitimit	(716)	(918)

Rakordimi i i shpenzimit të tatim fitimit me fitimin/(humbjen) kontabël për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015 është si më poshtë:

		2016		2015
Fitimi (humbja) kontabël para tatimit		420,117		(2,709,013)
Tatim fitimi me normën lokale të fitimit	15%	63,018	15%	(406,352)
Shpenzimet e pazbritshme	1%	2,589	(3)%	69,245
Diferenca të përkohshme të zbritshme të shtyra	5%	21,327	(9)%	233,825
Njohje e diferencave të përkohshme të shtyra në periudhat e mëparshme	(22)%	(91,911)	-	-
Ndryshimi në vlerën tatimore të mbartur	1%	4,261	(4)%	102,364
Shpenzimi i tatim fitimit	-	(716)	-	(918)

Në 31 Dhjetor 2016, aktivet tatimore të shtyra nuk janë njohur për humbje tatimore në shumën Lek 4,261 mijë (2015: Lek 102,364 mijë) sipas periudhave përkatëse të pa audituara të raportimit.

Shpenzimet e pazbritshme janë të detajuara si më poshtë:

	2016	2015
Humbje nga kredi dhe overdrifte të pambledhshme	10,976	460,437
Humbje të ndryshme operacionale	(9,171)	58,924
Zhvlrësimi i inventarit	(6,341)	(147,090)
Penalitet	3,312	1,026
Zhvlrësimi dhe amortizimi	(889)	18,911
Shpenzime personeli	3,359	34,922
Marketing dhe sponsorizime	3,884	3,520
Të tjera	12,132	30,983
Totali	17,262	461,633
Llogaritur 15%	2,589	69,245a

Ndryshimet e përkohshme në shpenzimet e zbritshme lidhen me ekspozimet e fshira të klientëve dhe konsiderohen si shpenzime fiskalisht të zbritshme vetëm me përmbushjen e kriterëve respektive të përcaktuara në legjislacionin tatimor dhe me ezaurimin e përpjekjeve për rikupërim. Gjatë 2016, Banka rishqyrtoi aspektin kohor të zbritshmërisë fiskale të ekspozimeve të fshira të klientëve dhe konsideroi rideklarimin e deklaratës tatimore për vitin 2015.

Bazuar në konsulencën e keshilluesve fiskal dhe vendimin teknik nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtimi i Bankës beson që llogaritja e Tatimit mbi të Ardhurat është e saktë dhe e përshtatshme pavarësisht pasigurive të hasura në ambientin fiskal e legjislacionin tatimor në fuqi si dhe beson që kontrollet e ardhshme tatimore nuk do të kenë ndonjë impakt domethënës në pozicionin financiar, operacionet apo flukset monetare të Bankës.

30. ANGAZHIME DHE DETYRIMET E KUSHTËZUARA

Angazhimet dhe detyrimet e kushtëzuara më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Aktive të kushtëzuara	1,927,383	1,019,503
Garanci në favor të klientëve	1,497,848	510,954
Angazhime në favor të klientëve	429,535	508,549
Detyrime të kushtëzuara	33,440,058	32,438,207
Garanci të vendosura nga klientët e kredive	1,591,986	958,667
Garanci të marra nga klientët e kredive	31,848,072	31,479,540

Letrat e kredisë dhe garancitë e dhëna te klientët e detyrojnë Bankën të kryejë pagesa në emër të klientëve në rast të mospërbushjes së detyrimit nga ana e klientit sipas kushteve të kontratës.

Angazhimet për të zgjeruar kreditimin përfaqësojnë angazhimet kontraktuale për të dhënë kredi dhe për të rinovuar kreditë. Përgjithësisht, angazhimet kanë data fikse maturimi, ose klauzola të tjera përfundimi.

31. ÇËSHTJET LIGJORE

Banka është subjekt i procedurave ligjore, ankimimeve dhe çështjeve gjyqësore gjatë aktivitetit normal të saj. Banka ka në funksion kontrolle formale dhe politika për menaxhimin e çështjeve dhe kërkesave ligjore. Pasi përfitohet këshilla profesionale dhe shuma e humbjes vlerësohet në mënyrë të arsyeshme, Banka bën rregullimet përkatëse për të reflektuar efektet negative që ankimimet

dhe çështjet gjyqësore mund të kenë mbi gjëndjen e saj financiare. Në fund të vitit, Banka ka pasur disa ankimime pa humbje potenciale materiale, për rrjedhojë Banka nuk ka provigjionuar për shpenzimet e rrezikut operacional shumat e përmendura në shënimin 18 të këtyre pasqyrave financiare .

32. ANGAZHIMET PËR QIRATË DHE SHPENZIMET PËR QIRATË OPERATIVE

Angazhimet e Bankës për qiratë minimale operative te pa anulueshme më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Jo më shumë se 1 vit	64,855	96,263
Midis 1 vit dhe 5 vjet	260,645	184,961
Më shumë se 5 vjet	98,003	57,012
Totali	423,503	338,236

Shuma e shpenzimeve të qirasë operative të njohura në fitim ose humbje si shpenzime qiraje për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016 është Lek 124,336 mijë (2015: Lek 166,032 mijë).

33. TRANSAKSIONET E PALËVE TË LIDHURA

Shoqëria mëmë e kompanisë për vitin 2016 është Tranzit Sh.p.k, e cila zotëron 100% të aksioneve. Banka konsideron të gjitha transaksionet e kësaj natyre me palët e lidhura në përputhje me Standartin Ndërkombëtar të Kontabilitetit 24 (SNK 24), detajuar si më poshtë:

Drejtimesit kryesor dhe palët e lidhura me drejtimesit kryesor:

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, anëtarët e Këshillit Administrative dhe drejtues të tjerë kryesor të cilët

janë persona që kanë autoritetin dhe përgjegjësinë për të planifikuar, drejtuar dhe kontrolluar aktivitetet e Kompanisë, në mënyrë direkte ose indirekte, përfshirë çdo drejtor (ekzekutiv ose jo) i Bankës, së bashku "drejtimesit kryesor", familjarët e afërt të drejtimesve kryesor, si dhe shoqëritë dhe bizneset e kontrolluara, ose që kontrollohen bashkërisht nga drejtimesit dhe/ose familjarët e tyre të afërt. Transaksionet e mëposhtme të cilat kanë ndodhur gjatë periudhës 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015 paraqiten si vijon:

	Tranzit Sh.p.k		Tranzit Sh.p.k		Credit Agricole S.A	
	Tranzit Sh.p.k Grup 1 Janar deri 31 Dhjetor 2016	Drejtimesit kryesor dhe palë të tjera të lidhura 1 Janar deri 31 Dhjetor 2016	Tranzit Sh.p.k Grup 12 Tetor 2015 deri 31 Dhjetor 2015	Drejtimesit kryesor dhe palë të tjera të lidhura 12 Tetor 2015 deri 31 Dhjetor 2015	Credit Agricole S.A Grup 1 Janar 2015 deri 12 Tetor 2015	Drejtimesit kryesor dhe palë të tjera të lidhura 1 Janar 2015 deri 12 Tetor 2015
Aktivitet në fund të vitit	270,513	5,936	-	8,054	1,667,179	8,982
Kredi dhe paradhënie të dhëna	270,513	5,936	-	8,054	1,667,179	8,982
Detyrimet në fund të vitit	1,443,877	16,613	1,176,521	17,827	963,898	10,611
Ndaj Bankave	-	-	-	-	-	-
Ndaj klientëve	351,968	16,613	62,925	17,827	-	10,611
Borxhi i varur	1,091,909	-	1,113,597	-	963,898	-
Të ardhura në fund të vitit	1,463	286	67	71	32	274
Interesa dhe të ardhura të ngjashme	53	233	-	60	32	217
Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet	1,410	53	67	11	-	57
Shpenzime në fund të vitit	67,275	121	20,403	49	56,225	89
Interesa dhe shpenzime të ngjashme	35,883	121	12,770	49	21,208	89
Shpenzime nga tarifat dhe komisionet	-	-	-	-	16,686	-
Asistencë teknike	31,392	-	7,633	-	18,331	-
Përfitime afatshkurtra të menaxhimit						-
Kompesimet e administratorëve	-	29,825	-	7,151	-	68,532
Paga	-	19,168	-	3,577	-	35,802
Bonuse	-	2,470	-	2,383	-	30,114
Tarifa për BoD	-	8,187	-	1,191	-	2,617

34. NGJARJET PAS DATËS SË RAPORTIMIT

Për të përmirësuar treguesit e kapitalizimit të Bankës, me efektivitet nga data 29 Mars 2017, pjesa prej EUR 2.03 milion u transferua nga Borxhi i Varur në Kapital të Paguar të Bankës. Borxhi i varur u ul nga EUR 8.03 milion në 6.00 milion dhe njëkohësisht Kapitali i Paguar

i Bankës u rrit me të njëjtën shumë.

Drejtimi i Bankës nuk është në dijeni për ngjarje materiale pas periudhës së raportimit që do të kërkonin rregullime apo informacione shpjeguese shtesë në pasqyrat financiare.



abi

AMERICAN BANK
OF INVESTMENTS

ANNUAL REPORT 2016